

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë

REZULTATET E SONDAZHIT KOMBËTAR TË STUDENTËVE

SKS2025

2025

**Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies në
arsimin e lartë**

**Raport mbi rezultatet e Sondazhit Kombëtar të Studentëve për
vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies në Institucionet e Arsimit të Lartë**

SKS 2025



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

Blloku i Ambasadave, Rruga “Skënderbeg”, Pallati nr. 8, Shkalla 1, Tiranë

**info@ascal.al
www.ascal.al**

PËRMBAJTJA

I.	HYRJE	6
II.	KONTEKSTI DHE OBJEKTIVAT.....	8
III.	REZULTATE TË PËRGJITHSHME TË SONDAZHIT	11
IV.	REZULTATET ANALITIKE TË SONDAZHIT	28
	4.1. METODOLOGJIA DHE ZHVILLIMI I SKS 2025.....	28
	4.2. CILËSIA E MËSIMDHËNIES NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË...36	
	4.2.1. Seksioni 1, Mësimdhënia dhe mësimnxënia.....	36
	4.2.2. Seksioni 2: Vlerësimi dhe feedback-u	43
	4.2.3. Seksioni 3: Burimet në funksion të mësimdhënies	54
	4.2.4. Seksioni 4: Organizimi dhe realizimi i programeve	61
	4.2.5. Seksioni 5: Mbështetja dhe zëri i studentëve	70
	4.2.6. Seksioni 6: Vlerësimi i përgjithshëm i programit /institucionit	77
V.	ANALIZA KRAHASUESE DHE PËRFUNDIME	89
	5.1. Vlerësim i përgjithshëm mbi metodologjinë e zhvillimit të SKS	89
	5.2. Vlerësimi i përgjithshëm i mësimdhënies dhe treguesit që ndikojnë në cilësinë e mësimdhënies në arsimin e lartë	89
VI.	ANEKSE.....	95
	6.1. Formati i pyetësorit të studentëve	95

Figura 1: Numri i studentëve në IAL publike dhe jopublike	11
Figura 2: Koha e shpenzuar për plotësimin e SKS	13
Figura 3: IAL Publike: Pjesëmarrja krahasuar me numrin total të studentëve	14
Figura 4: IAL publike-Pjesëmarrja në %	14
Figura 5: IAL Jopublike: Pjesëmarrja krahasuar me numrin total të studentëve	15
Figura 6: IAL Jopublike: Pjesëmarrja krahasuar me numrin total të studentëve	16
Figura 7: Kontributi në % i çdo IAL në SKS 2025	17
Figura 8: Pjesëmarrja e studentëve në pyetësor sipas gjinisë.....	18
Figura 9: Pjesëmarrja e studentëve në pyetësor sipas gjinisë, sipas llojit të institucionit.	19
Figura 10: Pjesëmarrja sipas programit të studimit.....	20
Figura 11: Pjesëmarrja sipas grupmoshës	20
Figura 12: Zgjedhja e programit të studimit.....	21
Figura 13: Zgjedhja e programit të studimit sipas llojit të institucionit.....	22
Figura 14: Rizgjedhja e programit të studimit.....	22
Figura 15: Rizgjedhja e programit të studimit sipas llojit të institucionit.....	23
Figura 16: Niveli i cilësisë së arsimit të lartë në Shqipëri	24
Figura 17: Niveli i cilësisë së arsimit të lartë në Shqipëri, sipas llojit të institucionit	25
Figura 18: Takimet informuese të zhvilluara në institucionet e arsimit të lartë	32
Figura 19: Takimet informuese të zhvilluara në institucionet e arsimit të lartë	33
Figura 20: Kompetenca e personelit akademik në shpjegim	37
Figura 21: Kompetenca e personelit akademik në shpjegim, sipas llojit të institucionit ...	38
Figura 22: Thellimi i koncepteve dhe njohurive	38
Figura 23: Thellimi i koncepteve dhe njohurive, sipas llojit të institucionit	39
Figura 24: Inkurajimi i studentëve për të marrë pjesë në aktivitete studimore	39
Figura 25: Inkurajimi i studentëve për të marrë pjesë në aktivitete studimore, sipas llojit të institucionit	40
Figura 26: Zbatimi i njohurive në praktikë	40
Figura 27: Zbatimi i njohurive në praktikë, sipas llojit të institucionit.....	41
Figura 28: Metodatat e vlerësimit	44
Figura 29: Korrektësia e vlerësimit	44
Figura 30: Korrektësia e vlerësimit, sipas llojit të institucionit	45
Figura 31: Ndhimesa e personelit akademik për të kuptuar lëndën	45
Figura 32: Ndhimesa e personelit akademik për të kuptuar lëndën, sipas llojit të institucionit	46
Figura 33: Plagjiatura dhe kopjimi	46
Figura 34: Plagjiatura dhe kopjimi, sipas llojit të institucionit	47
Figura 35: Ndhimesa nga personeli akademik, për të marrë me të mirën gjatë studimeve	47
Figura 36: Ndhimesa nga personeli akademik, për të marrë me të mirën gjatë studimeve, sipas llojit të institucionit	48
Figura 37: Vlerësimi i drejtë	48
Figura 38: Vlerësimi i drejtë, sipas llojit të institucionit	49
Figura 39: Kontakti me personelin akademik	49
Figura 40: Kontakti me personelin akademik, sipas llojit të institucionit	50
Figura 41: Infrastruktura e klasave	54
Figura 42: Infrastruktura e klasave, sipas llojit të institucionit	55
Figura 43: Infrastruktura e pajisjeve logjistike dhe IT	55
Figura 44: Infrastruktura e pajisjeve logjistike dhe IT, sipas llojit të institucionit	56
Figura 45: Aksesimi dhe cilësia e bibliotekës.....	56

Figura 46: Aksesit dhe cilësia e bibliotekës, sipas llojit të institucionit.....	57
Figura 47: Aksesit dhe cilësia e bibliotekës digjitale	57
Figura 48: Aksesit dhe cilësia e bibliotekës digjitale, sipas llojit të institucionit	58
Figura 49: Literatura në bibliotekë	58
Figura 50: Literatura në bibliotekë, sipas llojit të institucionit	59
Figura 51: Pritshmëritë e të nxënësve.....	62
Figura 52: Pritshmëritë e të nxënësve, sipas llojit të institucionit.....	62
Figura 53: Përbajtja e lëndëve.....	63
Figura 54: Përbajtja e lëndëve, sipas llojit të institucionit.....	63
Figura 55: Ngarkesa dhe orari i mësimi	64
Figura 56: Ngarkesa dhe orari i mësimi, sipas llojit të institucionit.....	64
Figura 57: Veprimtaritë mësimore	65
Figura 58: Veprimtaritë mësimore, sipas llojit të institucionit	65
Figura 59: Organizimi dhe funksionimi i programit të studimit	66
Figura 60: Organizimi dhe funksionimi i programit të studimit, sipas llojit të institucionit	66
Figura 61: Liria e shprehjes së mendimit	71
Figura 62: Liria e shprehjes së mendimit, sipas llojit të institucionit	71
Figura 63: Trajtimi i barabartë i studentëve	72
Figura 64: Trajtimi i barabartë i studentëve, sipas llojit të institucionit.....	72
Figura 65: Marrja në konsideratë e pikpamjeve dhe opinionit të studentëve	73
Figura 66: Marrja në konsideratë e pikpamjeve dhe opinionit të studentëve, sipas llojit të institucionit	73
Figura 67: Informimi i studentëve mbi të drejtat dhe detyrimet	74
Figura 68: Informimi i studentëve mbi të drejtat dhe detyrimet, sipas llojit të institucionit	74
Figura 69: Cilësia në përgjithësi e programit të studimit	78
Figura 70: Cilësia në përgjithësi e programit të studimit, sipas llojit të institucionit	78
Figura 71: Rizgjedhja e institucionit.....	79
Figura 72: Rizgjedhja e institucionit, sipas llojit.....	79
Figura 73: Cilësia e përgjithshme e personelit akademik	80
Figura 74: Cilësia e përgjithshme e personelit akademik, sipas llojit të institucionit.....	80
Figura 75: Cilësia e përgjithshme e personelit administrativ.....	81
Figura 76: Cilësia e përgjithshme e personelit administrativ, sipas llojit të institucionit....	81
Figura 77: Cilësia e përgjithshme e metodave të mësimdhënies	82
Figura 78: Cilësia e përgjithshme e metodave të mësimdhënies, sipas llojit të institucionit	82
Figura 79: Cilësia e përgjithshme e mbështetjes së studentëve.....	83
Figura 80: Cilësia e përgjithshme e mbështetjes së studentëve, sipas llojit të institucionit	83
Figura 81: Niveli i cilësisë së arsimit të lartë në Shqipëri	84
Figura 82: Niveli i cilësisë së arsimit të lartë në Shqipëri, sipas llojit të institucionit	84

I. HYRJE

Korniza ligjore e arsimit të lartë në Shqipëri, e përcaktuar nga ligji nr. 80/2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”*, vendos bazat për një sistem të qartë dhe të qëndrueshëm sigurimi të cilësisë. Ky ligj përcakton rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve kryesorë që kontribuojnë në ruajtjen dhe përmirësimin e standardeve akademike: nga njëra anë, institucionet e arsimit të lartë që zhvillojnë mekanizmat e sigurimit të brendshëm të cilësisë, dhe nga ana tjetër, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), Bordi i Akreditimit (BA) dhe Ministria e Arsimit, të cilat sigurojnë mbikëqyrjen e jashtme dhe vlerësimin e cilësisë.

Këto institucione veprojnë në bashkëpunim për të garantuar që arsimi i lartë në Shqipëri të përmbushë standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, duke u orientuar drejt përmirësimit të vazhdueshëm dhe transparencës në proceset akademike.

Sigurimi i cilësisë mbetet një proces dinamik që kërkon përkushtim të vazhdueshëm nga të gjitha palët, në mënyrë që arsimi i lartë t’u përgjigjet pritshmërive në rritje të studentëve për programe studimi bashkëkohore, mësimdhënie me cilësi të lartë dhe shërbime që mbështesin zhvillimin e tyre akademik dhe profesional.

Pikërisht për këtë arsye, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) organizon çdo tre vjet Sondazhin Kombëtar të Studentëve (SKS). Ky sondazh u jep studentëve fjalën kryesore: mundësinë për të shprehur mendimin e tyre mbi cilësinë e mësimdhënies, programet e studimit dhe shërbimet që marrin nga institucionet e arsimit të lartë. Mendimi i tyre është thelbësor, sepse ndihmon jo vetëm Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe Bordin e Akreditimit, por edhe vetë institucionet e arsimit të lartë që të kuptojnë më mirë përvojën studentore dhe të përmirësojnë mënyrën se si funksionojnë.

Që nga sondazhi i parë i zhvilluar në vitin akademik 2018–2019, Sondazhi Kombëtar i Studentëve është kthyer në një traditë të rëndësishme. Ai ka ndihmuar institucionet të kuptojnë më qartë perceptimin e studentëve dhe ka forcuar kulturën e transparencës dhe përmirësimit të vazhdueshëm. Sondazhi i vitit 2022 solli përmirësime të dukshme, duke reflektuar ndryshimet që ndodhën në sistemin e sigurimit të cilësisë pas miratimit të plotë të Kodit të Cilësisë.

Në këtë vazhdimësi, SKS 2025 vjen me qëllimin për të ofruar një pasqyrë sa më të qartë dhe gjithëpërfshirëse të eksperiencës studentore në të gjitha universitetet publike dhe jopublike në Shqipëri. Ky raport nuk synon të krahasojë ose rendisë institucionet, por të sjellë të dhëna të besueshme dhe të

dobishme për studentët, universitetet, politikëbërësit dhe publikun e gjerë. Në fund të fundit, studentët janë përfituesit kryesorë të arsimit të lartë dhe zëri i tyre është udhërrëfyesi më i rëndësishëm për të ndërtuar një sistem më cilësor dhe më të drejtë.

II. KONTEKSTI DHE OBJEKTIVAT

Sondazhi Kombëtar i Studentëve (SKS) është një instrument i parashikuar nga Ligji nr. 80/2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”* dhe një nga detyrat thelbësore të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) në kuadër të sigurimit të cilësisë. Ai realizohet periodikisht, çdo tre vjet, dhe ka për qëllim të mbledhë opinionin e studentëve mbi përvojën e tyre akademike. Metodologjia e pyetësorëve dhe sondazheve është e njohur ndërkombëtarisht dhe përdoret gjerësisht jo vetëm për të vlerësuar mësimdhënien, por edhe për të analizuar funksionimin e sistemeve të arsimit të lartë në tërësi.

Ky sondazh shërben si një mjet i vlefshëm për:

- Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe Bordin e Akreditimit, për të monitoruar dhe vlerësuar cilësinë e arsimit të lartë;
- institucionet e arsimit të lartë, për të marrë feedback të drejtpërdrejtë nga studentët dhe për të përmirësuar programet e tyre;
- Ministrinë e Arsimit, për të hartuar politika të bazuara në evidencë;
- studentët dhe publikun e gjerë, për të pasur një pasqyrë të qartë mbi realitetin e arsimit të lartë në Shqipëri.

Qëllimi kryesor i Sondazhit Kombëtar të Studentëve 2025 është të japë një panoramë të besueshme dhe gjithëpërfshirëse mbi perceptimin e studentëve, duke ndihmuar në forcimin e kulturës së cilësisë dhe në zhvillimin e mëtejshëm të arsimit të lartë në vend. Marrja e mendimit të studentëve është një burim i pazëvendësueshëm informacioni, pasi ndihmon në vlerësimin real të cilësisë së mësimdhënies dhe është i domosdoshëm si në sigurimin e brendshëm, ashtu edhe në sigurimin e jashtëm të cilësisë.

Këto të dhëna janë të vlefshme për:

- hartimin e politikave që synojnë përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë,
- vendimmarrjen institucionale për zhvillimin e programeve, dhe
- orientimin e studentëve dhe maturantëve për zgjedhjen e institucioneve dhe programeve të studimit.

Përfshirja e studentëve në këtë proces është një element kyç. Duke ndarë përvojat, vlerësimet dhe sugjerimet e tyre, ata kontribuojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e mësimdhënies dhe forcimin e kulturës së cilësisë në institucionet shqiptare të arsimit të lartë.

Së fundmi, informacioni që sigurohet nëpërmjet Sondazhit Kombëtar të Studentëve (SKS) ka një rol të dyfishtë dhe thelbësor. Nga njëra anë, ai u shërben studentëve aktualë si burim i vlefshëm informacioni mbi cilësinë e arsimit të lartë në institucionet ku ata studiojnë duke reflektuar drejtpërdrejt

përvojën e tyre të përditshme në auditorë, në mësimdhënie, në marrëdhënien me pedagogët dhe në shërbimet universitare. Nga ana tjetër, rezultatet e SKS janë një orientim i rëndësishëm për studentët e rinj dhe familjet e tyre, duke u dhënë atyre një pasqyrë më të qartë mbi cilësinë e programeve dhe institucioneve, përpara se të bëjnë zgjedhjet e tyre akademike. Përtej këtyre dy dimensioneve, Sondazhi Kombëtar i Studentëve shërben edhe si një mekanizëm transparence për publikun e gjerë, i cili mund të njihet me perceptimin real të studentëve mbi arsimin e lartë në Shqipëri.

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë rithekson se sondazhe të tilla nuk kanë vetëm funksionin e matjes së cilësisë, por edhe atë të ndërgjegjësimit të studentëve mbi rolin e tyre si aktorë kryesorë të jetës akademike. Studentët janë përfituesit kryesorë të arsimit të lartë, por njëkohësisht edhe kontribues aktivë në përmirësimin e tij. Duke dhënë mendimet, sugjerimet dhe përjetimet e tyre, ata ndikojnë në forcimin e kulturës së cilësisë dhe e ndihmojnë sistemin të bëhet më i hapur dhe më i përgjegjshëm.

Në Sondazhin Kombëtar të Studentëve 2025 morën pjesë 38 institucione të arsimit të lartë, publike dhe jopublike, dhe pyetësi u përcoll tek një numër prej 113672 studentësh. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë bashkëpunoi ngushtësisht me Këshillat Studentorë në çdo institucion, duke i përfshirë studentët në diskutime dhe konsultime për përmirësimin e pyetësit dhe procedurave të zhvillimit të sondazhit. Ky partneritet ndihmoi që procesi të ishte më i thjeshtë, më i qartë dhe më i aksesueshëm për të gjithë.

Për të garantuar zbatimin në terren, brenda çdo institucioni u ngritën grupe pune, ku përfshiheshin edhe studentë. Këto grupe u kujdesën për koordinimin e procesit, shpërndarjen e informacionit dhe krijimin e kushteve praktike për plotësimin e pyetësorëve. Institucionet e Arsimit të Lartë vunë në dispozicion listën e studentëve aktivë me adresat e tyre elektronike, si dhe sallat apo laboratorët e informatikës për të mundësuar plotësimin e pyetësorëve në mënyrë të organizuar. Megjithatë, theksohet se institucionet nuk patën asnjë të drejtë të ndërhyjnë apo të ndikojnë në gjykimin e lirë të studentëve, duke respektuar parimin e anonimatit dhe pavarësisë së përgjigjeve. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, në cilësinë e institucionit përgjegjës, administroi tërësisht procesin, duke hartuar dhe zbatuar metodologjinë, ndërtuar instrumentet për zhvillimin e sondazhit, organizuar kalendarin e veprimtarive dhe siguruar burimet njerëzore e financiare të nevojshme për zbatimin e tij. Metodologjia dhe plani i veprimit për realizimin e sondazhit u miratuan nga Bordi i Akreditimit.

Në bashkëpunim të ngushtë me institucionet, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë ndoqi hap pas hapi ecurinë e procesit, duke garantuar transparencë dhe korrektësi. Për zbatimin e sondazhit u ngritën grupe pune të

dedikuara që menaxhuan çdo fazë, nga shpërndarja e pyetësorëve, tek mbledhja e të dhënave dhe analiza përfundimtare.

Një element kyç ishte miratimi i pyetësorit nga Bordi i Akreditimit, pas një diskutimi të gjerë mbi objektivat dhe rëndësinë e tij. Bordi i Akreditimit, përveçse mbështeti zhvillimin e sondazhit, në fund të procesit shqyrtoi edhe raportet përfundimtare përpara publikimit, duke garantuar që ato të ishin të plota dhe të besueshme. Në disa raste, bazuar në gjetjet e sondazhit, Bordi i Akreditimit ka propozuar përmirësime të mëtejshme në manualin e sondazhit, në procedurat e zhvillimit, madje edhe në kuadrin ligjor e politikëbërës, me synim forcimin e mëtejshëm të cilësisë në arsimin e lartë.

III. REZULTATE TË PËRGJITHSHME TË SONDAZHIT

Ky seksion paraqet një përmbledhje të përgjithshme mbi rezultatet e pyetësorit të Sondazhit Kombëtar të Studentëve (SKS) 2025, duke analizuar disa nga treguesit kryesorë të tij. Pyetjet janë grupuar në gjashtë fusha vlerësimi, të cilat shërbejnë për të strukturuar perceptimin e studentëve sipas llojit të institucionit (publik/jopublik), ciklit të studimit dhe profileve të ndryshme të programeve.

Një sfidë që vijon të evidentohet është pjesëmarrja ende e ulët e studentëve në plotësimin e pyetësorit. Sipas të dhënave të administruara nga ASCAL, në total u vunë në dispozicion 115.538 kontakte studentësh nga të gjitha IAL-të. Pas verifikimeve teknike, rezultoi se 113.672 adresa e-mail ishin funksionale dhe të mbështetura nga platforma e SKS, prej të cilave 79.678 i përkisnin institucioneve publike dhe 33.994 institucioneve jopublike.

Nga numri total prej 113.672 studentësh të cilëve u është shpërndarë pyetësori, 24.107 studentë e kanë plotësuar atë, ose 21.2%. Sipas llojit të institucionit, pyetësori është plotësuar nga 11.424 studentë (47%) që studiojnë në IAL publike, dhe 12.683 studentë (53%) që studiojnë në IAL jopublike.




Figura 1: Numri i studentëve në IAL publike dhe jopublike

Në raport me SKS 2019 dhe SKS 2022, numri i kontakteve të sakta të studentëve është rritur ndjeshëm falë përmirësimeve në administrimin e



databazave nga IAL, por kjo nuk është shoqëruar me një rritje të dukshme të nivelit të pjesëmarrjes. Për shembull, edhe pse në SKS 2025 u dërguan më shumë e-maile krahasuar me 2022, pjesëmarrja mbeti në nivele të njëjta.

Ky tregues tregon mundësinë për të forcuar metodologjinë e angazhimit të studentëve dhe për të rritur pjesëmarrjen e tyre aktive. Në sondazhet e ardhshme, ASCAL do të rishikojë metodologjinë, duke integruar mekanizma shtesë për motivimin e studentëve, si aktivitete promovuese, një rol më aktiv të këshillave studentore, si dhe një angazhim më të madh të institucioneve në informimin dhe ndërgjegjësimin e studentëve mbi rëndësinë dhe përfitimet e SKS. Kjo qasje synon të ofrojë një përvojë gjithëpërfshirëse dhe të angazhuar për të gjithë studentët.

Nga analiza rezulton se numri absolut i studentëve që iu përgjigjën pyetësorit është më i lartë në IAL jopublike, megjithëse në vlerë absolute studentët e institucioneve publike zënë përqindjen më të madhe të studentëve të cilëve u është shpërndarë pyetësori. Ky tregues pasqyron një nivel më të lartë të angazhimit tek studentët e IAL jopublike, krahasuar me ata të IAL publike. Në raport me SKS 2022, pjesëmarrja në SKS 2025 është pothuaj në të njëjtat nivele pavarësisht njoftimeve të përsëritura dhe shtyrjes së afateve për përfundimin e plotësimit të pyetësorëve. Ky fenomen tregon nevojën për masa shtesë që lidhen me rritjen e ndërgjegjësimin të studentëve mbi rolin e tyre në procesin e sigurimit të cilësisë.

ASCAL vlerëson se, për sondazhet e ardhshme, do të fokusohet në rishikimin dhe zbatimin e strategjive më efektive për nxitjen e pjesëmarrjes së studentëve, duke përfshirë fushata ndërgjegjësuere, rol më aktiv të këshillave studentore, si dhe zbatim të praktikave të mira ndërkombëtare.

Për të kuptuar më qartë cilësinë e përgjigjeve, është analizuar edhe koha mesatare e shpenzuar nga studentët në plotësimin e pyetësorit, e cila ofron tregues mbi seriozitetin e pjesëmarrjes dhe nivelin e angazhimit real të tyre.

Sikundër paraqitet edhe në grafikun e mëposhtëm, pjesa më e madhe e studentëve e kanë plotësuar pyetësorin në një kohë dukshëm më të shkurtër sesa koha mesatare e nevojshme për t'iu përgjigjur rreth 30 pyetjeve me vëmendje dhe reflektim. Nga një simulim paraprak, është vlerësuar se koha optimale për plotësimin normal të pyetësorit duhet të ishte rreth 15–20 minuta, ndërkohë që vetëm një numër shumë i kufizuar studentësh e kanë arritur këtë prag.

Në realitet, koha mesatare e shpenzuar nga studentët për plotësimin e pyetësorit rezulton të jetë më pak se 5 minuta. Kjo tregon se një pjesë e konsiderueshme e tyre janë përgjigjur me nxitim, pa reflektuar gjatë për përmbajtjen e pyetjeve.




Figura 2: Koha e shpenzuar për plotësimin e SKS

Të dhënat e SKS 2025 tregojnë se pjesëmarrja e ponderuar e studentëve nuk është e shpërndarë në mënyrë të barabartë ose të përafërt midis institucioneve të arsimit të lartë.

Një pjesë e konsiderueshme e përgjigjeve totale vjen nga disa institucione me numër më të madh studentësh dhe me norma më të larta pjesëmarrjeje. Për shembull, institucione si USH (8.5%), UMT (6.3%), UMSH (5.7%), U. Aldent (5.3%) dhe UE (5.0%), së bashku përbëjnë mbi 30% të totalit të të gjithë përgjigjeve në nivel kombëtar.

Në këtë kontekst, rezultatet përfundimtare të SKS 2025 pasqyrojnë në mënyrë të veçantë opinionin e studentëve nga një grup institucionesh me pjesëmarrje më të lartë. Për institucionet më të vogla ose ato me norma më të ulëta përgjigjesh, përfaqësimi në panoramën kombëtare është më modest, duke ofruar një mundësi të qartë për përmirësim.

Në të ardhmen, ASCAL dhe institucionet do të punojnë për të balancuar pjesëmarrjen, duke forcuar motivimin e studentëve në IAL më të vogla dhe në ato me norma më të ulëta përgjigjesh.




Figura 3: IAL Publike-Pjesëmarrja krahasuar me numrin total të studentëve




Figura 4: IAL publike-Pjesëmarrja në %




Figura 5: IAL Jopublike-Pjesëmarrja krahasuar me numrin total të studentëve




Figura 6: IAL Jopublike-Pjesëmarrja krahasuar me numrin total të studentëve

Analiza e SKS 2025 evidenton një mundësi për të rritur ekuilibrin në shpërndarjen e pjesëmarrjes midis institucioneve të arsimit të lartë. Me nisma të ardhshme për të rritur angazhimin e studentëve, çdo institucion, pavarësisht nga madhësia ose niveli i pjesëmarrjes, do të ketë mundësinë të kontribuojë në mënyrë të barabartë dhe të ndikojë në formësimin e rezultateve kombëtare. Në mënyrë krahasuese, grafiku i mëposhtëm paraqet numrin e studentëve pjesëmarrës për çdo institucion në raport me numrin total të studentëve që kanë marrë pjesë në SKS 2025. Grafiku nxjerr në pah se, megjithëse disa institucione kanë numër shumë të madh studentësh, përqindja e pjesëmarrjes së tyre në sondazh është dukshëm e ulët.

Në të kundërt, në institucionet jopublike dhe në disa institucione publike me madhësi më të vogël, pjesëmarrja e studentëve rezulton më e lartë dhe më e qëndrueshme, duke reflektuar një kulturë më të konsoliduar angazhimi në këtë proces.




Figura 7: Kontributi në % i çdo IAL në SKS 2025

Është e rëndësishme të ritheksohet se përqindja e pjesëmarrjes ka një rol thelbësor jo vetëm për analizën statistikore të të dhënave, por edhe për përmirësimin e nivelit të vlerësimit dhe interpretimit të tyre.

SKS 2025 është një instrument i vlefshëm për matjen e cilësisë së mësimdhënies dhe përvojës studentore. Në këtë fazë, disa institucione me pjesëmarrje më të madhe të studentëve kanë kontribuar në mënyrë të dukshme në rezultatet e përgjithshme, duke dhënë një pasqyrë të vlefshme të situatës aktuale.

Në sondazhet e ardhshme, ASCAL do të rishohë përfshirjen e metodave statistikore të peshimit dhe ekuilibrit të pjesëmarrjes duke siguruar një pasqyrë më të balancuar dhe gjithëpërfshirëse për të gjithë institucionet pjesëmarrëse.

Rezultatet e SKS 2025 tregojnë se pjesëmarrja e studentëve femra është dukshëm më e lartë se ajo e studentëve meshkuj në të dy llojet e institucioneve.




Figura 8: Pjesëmarrja e studentëve në pyetësor sipas gjinisë

Në IAL publike, diferenca është më e theksuar: pasi dyfishi i përgjigjeve i përkasin femrave, duke lënë një përfaqësim relativisht të ulët të studentëve meshkuj. Në IAL jopublike, edhe pse balanca gjinore është më e afërt, sërish studentet femra dominojnë me 54.5% të pjesëmarrjes në raport me meshkujt. Kjo shpërndarje tregon se studentet femra janë më aktive në dhënien e feedback-ut për cilësinë e mësimdhënies dhe shërbimet akademike.




Figura 9: Pjesëmarrja e studentëve në pyetësor sipas gjinisë, sipas llojit të institucionit

Gjithashtu, rezultatet tregojnë qartë se pjesëmarrja në SKS 2025 dominohet nga studentët e programeve Bachelor, të cilët përbëjnë gati 60% të përgjigjeve. Kjo është e pritshme, pasi programet Bachelor përfaqësojnë pjesën më të madhe të numrit të studentëve në IAL.

Ndërkohë, programet e integruara Master i Shkencave (16.22%) dhe Master i Shkencave (9.82%) japin gjithashtu një kontribut të konsiderueshëm në sondazh, duke reflektuar angazhimin e studentëve në ciklet e larta.

Nga ana tjetër, pjesëmarrja në programet profesionale dhe Master Profesional është dukshëm më e kufizuar (së bashku rreth 10%).

Në programet e Doktoratës dhe Specializimeve afatgjata, përfshirja e studentëve mbetet ende e ulët (<1%), çka tregon hapësirë për përmirësim në këtë drejtim. Gjithashtu, një pjesë e studentëve (8.71%) nuk kanë deklaruar ciklin e studimit, duke theksuar nevojën për rritjen e ndërgjegjësimit dhe saktësinë në plotësimin e të dhënave në sondazhet e ardhshme.

Për përfshirje më të lartë të programeve profesionale dhe doktorale nevojiten fushata sensibilizuese të posaçme për të rritur angazhimin e studentëve në këto cikle. Sa më sipër, rezultatet e SKS 2025 mbështeten më shumë tek perceptimet e studentëve Bachelor.

Për të siguruar një pasqyrë më të balancuar dhe gjithëpërfshirëse, është e nevojshme që në sondazhet e ardhshme të rritet ndjeshëm pjesëmarrja e cikleve më të larta dhe profesionale ose të vendosen koeficiente ponderimi për interpretime të sakta statistikore.




Figura 10: Pjesëmarrja sipas programit të studimit




Figura 11: Pjesëmarrja sipas grupmoshës

Rezultatet tregojnë një pjesëmarrje dominuese dhe inkurajuese të studentëve të rinj (18–22 vjeç) në SKS 2025, të cilët përbëjnë gati tre të katërtat e të gjitha përgjigjeve. Kjo përputhet natyrshëm me strukturën demografike të arsimit të lartë në vend, ku kjo grupmoshë zë shumicën e studentëve të regjistruar në

programet e ciklit të parë (Bachelor). Edhe grupmosha 23–27 vjeç paraqet një përfaqësim domethënës (12.7%), që reflekton pjesëmarrjen e studentëve të ciklit të dytë (Master) dhe të programeve të integruara.

Ndërkohë, pjesëmarrja e studentëve mbi 27 vjeç, megjithëse më e kufizuar, dëshmon për angazhimin e vazhdueshëm të individëve në arsimimin e mëtejshëm dhe në programe të specializuara, doktoratë apo ri-kualifikimi profesional.




Figura 12: Zgjedhja e programit të studimit

Pjesëmarrja në programe që ishin zgjedhje të dytë ose të tretë është relativisht e ngjashme në të dy sistemet (rreth 15% dhe 5%), ndërsa zgjedhjet e katërt e pestë mbeten minimale.

Ndërkohë, përqindja e studentëve pa përgjigje është rreth 8–9%, gjë që sugjeron nevojën për një koordinim më të mirë me IAL për të siguruar plotësimin e plotë të të dhënave.

Në përfundim, rezultatet e SKS 2025 tregojnë se zgjedhja e programit mbetet kryesisht e qëllimshme dhe e vetëdijshme, por, për të rritur më tej cilësinë e analizës, mbetet e rëndësishme që IAL-të të përmirësojnë evidentimin dhe mbledhjen e saktë të informacionit.




Figura 13: Zgjedhja e programit të studimit sipas llojit të institucionit

Nga rezultatet, vërehet një nivel i lartë vetëdijeje dhe informimi nga maturantët në procesin e përzgjedhjes së programeve të studimit. Kjo tregon se studentët janë gjithnjë e më të orientuar drejt fushave që përputhen me interesat dhe pritshmëritë e tyre profesionale, duke reflektuar një vendimmarrje të ndërgjegjshme dhe të qëllimshme në zgjedhjen e studimeve universitare.




Figura 14: Rizgjedhja e programit të studimit




Figura 15: Rizgjedhja e programit të studimit sipas llojit të institucionit

Rezultatet e Sondazhit Kombëtar të Studentëve 2025 (SKS 2025) japin një tablo të qartë mbi mënyrën se si studentët shqiptarë perceptojnë cilësinë e arsimit të lartë në vend, duke reflektuar një trend përmirësues krahasuar me ciklet e mëparshme të sondazhit.

Në nivel kombëtar, shumica e studentëve vlerësojnë pozitivisht përvojën e tyre akademike, me mbi gjysmën e të anketuarve që e konsiderojnë arsimin e lartë “mirë” ose “shumë mirë”. Kjo dëshmon për një ekuilibër pozitiv mes përpjekjeve të institucioneve për përmirësim të cilësisë dhe perceptimit të studentëve për rezultatet e këtyre përpjekjeve.

Në shkallë kombëtare, rreth 55 % (“mirë” ose “shumë mirë”) e studentëve e vlerësojnë arsimin e lartë në Shqipëri në nivele të larta të cilësisë, duke theksuar përparime në fushat e mësimdhënies, përdorimit të teknologjisë dhe përfshirjes institucionale. Rreth 11% e konsiderojnë cilësinë “mesatare”, ndërsa vetëm rreth 6–7% kanë dhënë vlerësime negative. 25% nuk i janë përgjigjur kësaj pyetjeje.




Figura 16: Niveli i cilësisë së arsimit të lartë në Shqipëri

Në grafikun më poshtë paraqitet vlerësimi i studentëve për nivelin e cilësisë së arsimit të lartë në Shqipëri, i ndarë sipas llojit të institucionit (publik dhe jopublik). Tendenca kryesore tregon se shumica e studentëve, si në institucionet publike ashtu edhe në ato jopublike, e klasifikojnë cilësinë në nivelet “Mirë” dhe “Shumë mirë”. Institucionet jopublike marrin vlerësime më të larta në kategorinë “Shumë mirë” (4,659 përgjigje), në krahasim me institucionet publike (3,228), duke reflektuar pritshmëri dhe perceptime më pozitive për cilësinë e ofruar.

Ndërkohë, nivelet e ulëta të vlerësimit (“Keq” dhe “Shumë keq”) përbëjnë një pjesë shumë më të vogël të përgjigjeve, çka tregon se perceptimet negative nuk janë dominuese. Numri i studentëve që deklarojnë se “nuk kanë informacion të mjaftueshëm” mbetet i ulët për të dyja kategoritë institucionale.

Në përgjithësi, studentët e institucioneve jopublike janë më pozitivë në vlerësimin e cilësisë, ndërsa studentët e institucioneve publike kanë shpërndarje më të balancuar midis “Mirë” dhe “As mirë as keq”. Rreth 6 000 studentë nuk kanë dhënë përgjigje.




Figura 17: Niveli i cilësisë së arsimit të lartë në Shqipëri, sipas llojit të institucionit

Në institucionet publike, perceptimi i studentëve është kryesisht pozitiv, që tregojnë kënaqësi dhe vlerësim të mirë për arsimin e lartë. Kjo tregon se universitetet publike vazhdojnë të ruajnë një besim të qëndrueshëm te cilësia akademike dhe reputacioni i tyre institucional. Studentët vlerësojnë më së shumti përgatitjen e stafit akademik dhe seriozitetin e programeve të studimit, por një pjesë e konsiderueshme mban qëndrim neutral, duke sinjalizuar nevojën për më shumë personalizim në përvojën studentore, përmirësim të shërbimeve mbështetëse dhe komunikim më efektiv me studentët.

Në institucionet jopublike, perceptimi është edhe më i lartë: shumica e studentëve e konsiderojnë cilësinë “mirë” ose “shumë mirë”. Ky rezultat përforcon idenë se mjediset akademike më të vogla, fleksibiliteti i strukturave, kujdesi individual ndaj studentëve dhe infrastruktura moderne kanë ndikuar ndjeshëm në përmirësimin e përvojës dhe kënaqësisë studentore. Studentët e këtyre institucioneve ndjejnë një lidhje më të afërt me pedagogët dhe stafin administrativ, si dhe një gatishmëri më të lartë të institucioneve për t’u përshtatur me nevojat e tyre.

Në analizë krahasuese, diferencat ndërmjet institucioneve publike dhe jopublike janë të dukshme, por jo kontradiktore. Studentët e IAL-ve jopublike kanë më shumë prirje për të dhënë vlerësime më të mira, ndërsa studentët e IAL-ve publike janë më të moderuar në vlerësim, duke dhënë përgjigje më të balancuara midis “mirë” dhe “mesatar”. Kjo pasqyron dy modele të ndryshme, por komplementare të arsimit të lartë në Shqipëri.

Në terma analitikë, këto rezultate duhen parë si një indikator i konsolidimit gradual të cilësisë në arsimin e lartë shqiptar. Tendencia drejt vlerësimeve pozitive tregon se sistemi arsimor po ecën drejt standardeve më të qëndrueshme, por në të njëjtën kohë thekson domosdoshmërinë e një qasjeje

të integruar midis politikave publike, zhvillimit institucional dhe përfshirjes aktive të studentëve.

Të dhënat më sipër në nivel kombëtar, tregojnë se perceptimi i studentëve për cilësinë e arsimit të lartë në Shqipëri është kryesisht pozitiv. Rreth 55.64%¹ e studentëve e vlerësojnë arsimin e lartë “mirë” ose “shumë mirë”, ndërsa 11% kanë dhënë vlerësim mesatar. Vetëm 7% e kanë vlerësuar “keq” ose “shumë keq”, dhe 1.5% kanë deklaruar se nuk kanë informacion të mjaftueshëm.

Këto të dhëna tregojnë se cilësia e arsimit të lartë në vend perceptohet pozitivisht nga shumica e studentëve, duke reflektuar përmirësime në mësimdhënie, infrastrukturë dhe përfshirje institucionale në vitet e fundit.

Ashtu si në sondazhet e mëparshme, edhe në SKS 2025 është evidentuar një nivel i ndryshueshëm vlerësimi i të dhënave midis institucioneve të ndryshme. Në disa raste, përqindjet e larta të vlerësimeve pozitive nuk pasqyrojnë plotësisht realitetin e treguar nga rezultatet e proceseve të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit nga ASCAL. Një pjesë e studentëve mund të mos e shohin SKS-në si një instrument të vërtetë reflektimi, por si një formë përfaqësimi pozitiv për institucionin e tyre. Kjo sugjeron nevojën për forcimin e kuptimit të studentëve mbi rolin e SKS-së si një mjet reflektimi të sigurt dhe konstruktiv për përmirësimin e cilësisë në institucionet e arsimit të lartë.

Gjithashtu, analiza e kohës së shpenzuar për plotësimin e pyetësorit dhe numrit të ndërveprimeve të regjistruara në sistem tregon një mundësi për të përmirësuar angazhimin e studentëve. Në disa raste, studentët e kanë plotësuar SKS-në në mënyrë të shpejtë, pa pasur gjithmonë mundësinë të reflektojnë thellësisht mbi pyetjet. Kjo ofron një bazë të qartë për të zhvilluar strategji që rrisin motivimin dhe reflektimin gjatë pjesëmarrjes në sondazhe të ardhshme.

Në terma analitikë, SKS 2025 konfirmon ekzistencën e një perceptimi pozitiv për cilësinë e arsimit të lartë në Shqipëri, megjithatë, nënvizon rëndësinë e forcimit të qasjes metodologjike në verifikimin dhe certifikimin e informacionit, për të mundësuar analiza gjithnjë e më të sakta dhe të qëndrueshme. Diferencat midis institucioneve të mëdha dhe të vogla, publike dhe jopublike, tregojnë se perceptimi i studentëve ndikohet ndjeshëm nga faktorë si afërsia me stafin akademik, numri i studentëve, mjedisi i të nxëniet dhe kultura institucionale.

¹ Nga totali 100% rreth 25% e studentëve pjesëmarrës në pyetësor nuk janë përgjigjur kësaj pyetje. Në grafikun më lart, paraqitja është bërë mbi totalin e studentëve pjesëmarrës jo mbi studentët që i janë përgjigjur pyetjes. Kështu, vlera 55.64 (32.72 + 22.92), merr në konsideratë dhe 25% të studentëve që nuk janë përgjigjur.

Në sondazhet e ardhshme, ASCAL synon të rishikojë dhe forcojë mekanizmin e verifikimit të të dhënave, duke e bazuar atë në analiza krahasuese me burime të tjera të besueshme, si akreditimet, auditimet e brendshme të cilësisë dhe sondazhet e zhvilluara nga institucionet e arsimit të lartë.

Në përfundim, SKS 2025 dëshmon një prirje të qëndrueshme përmirësimi në perceptimin e cilësisë së arsimit të lartë, por edhe nevojën për përmirësim të mëtejshëm të instrumenteve metodologjike dhe analitike për vlerësimin e të dhënave.

Përmirësimi i cilësisë është një proces i vazhdueshëm që kërkon përfshirje të singertë të studentëve, transparencë institucionale dhe analizë të faktorëve që ndikojnë perceptimin e tyre.

IV. REZULTATET ANALITIKE TË SONDAZHIT

4.1. METODOLOGJIA DHE ZHVILLIMI I SKS 2025

Në vijim të përvojës së mëparshme dhe në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të proceseve të sigurimit të cilësisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë ka vijuar traditën e zhvillimit të sondazheve kombëtare të dedikuara vlerësimit të cilësisë së arsimit të lartë dhe përvojës studentore në institucionet e arsimit të lartë.

Në SKS 2025, metodologjia është përditësuar duke reflektuar përvojat e fituara nga ciklet e mëparshme të sondazheve dhe duke theksuar respektimin e parimeve themelore të integritetit kërkimor:

- Anonimat i plotë i pjesëmarrësve;
- E drejta për të refuzuar pjesëmarrjen;
- Pavarësia dhe mos-ndikimi në përgjigje;
- Ruajtja e neutralitetit institucional gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave.

Qëllimi i SKS 2025 nuk është vendimmarrës, por analitik e përmirësues, rezultatet e tij shërbejnë si instrument orientues për analizat institucionale, për propozimet e politikave të brendshme të cilësisë dhe për hartimin e rekomandimeve konkrete që synojnë rritjen e cilësisë në arsimin e lartë shqiptar.

Pyetësi i SKS 2025 është strukturuar në gjashtë seksione kryesore, që përfshijnë fusha vlerësimi të lidhura drejtpërdrejt me përvojën akademike dhe administrative të studentëve:

1. Cilësia e mësimdhënies dhe e programeve të studimit;
2. Mbështetja akademike dhe administrative;
3. Infrastruktura dhe mjedisi universitar;
4. Përdorimi i teknologjisë dhe burimeve digjitale;
5. Përfshirja studentore dhe përvoja në praktikë;
6. Vlerësimi i përgjithshëm dhe kënaqësia me institucionin.

Pyetjet janë konceptuar në formate të ndryshme, duke kombinuar shkallët e vlerësimit (1–5), pyetje me përgjigje të mbyllura (po/jo) dhe komente të hapura, për të ofruar një kuptim sa më të plotë dhe cilësor të perceptimeve të studentëve. Kjo qasje e përzier lejon një analizë sasiore dhe cilësore të rezultateve, duke ruajtur një ekuilibër mes thjeshtësisë së pjesëmarrjes dhe vlerës analitike të të dhënave.

Në përputhje me Manualin e SKS, është përcaktuar edhe pragu minimal i pjesëmarrjes për t'u konsideruar një sondazh i besueshëm në nivel institucioni: Për IAL-të me mbi 500 studentë, pjesëmarrja e vlefshme duhet të përbëjë të paktën 10% të numrit total të studentëve të regjistruar; Për IAL-të me 50–500 studentë, pjesëmarrja duhet të jetë mbi 50%; Për IAL-të me më pak se 50

studentë, rezultatet nuk analizohen në nivel individual institucioni, por përfshihen në analizën e përgjithshme kombëtare dhe në ndarjen “IAL publike / IAL jopublike”.

Në SKS 2025, theksi është vënë tek rritja e saktësisë së analizës dhe verifikimi i integritetit të të dhënave, duke përdorur mekanizma kontrolli për: kohën e shpenzuar në plotësimin e pyetësorit, numrin e ndërveprimeve me sistemin, dhe koherencën e përgjigjeve ndërmjet seksioneve.

Analiza e përgjigjeve kryhet në mënyrë statistikore dhe rezultatet janë përmbledhje e përgjigjeve për indikatorë dhe pyetje të ndryshme. Në asnjë rast nuk identifikohet përgjigja me ID apo emrin e individit. *ASCAL garanton anonimin dhe konfidencialitetin e pjesëmarrësve në të gjitha fazat e realizimit të SKS* (nga dërgimi i aksesit në e-mail-in personal, përpunimin e rezultateve, publikim të informacioneve dhe arkivim të dokumentacionit).

Analiza e të dhënave kryhet në përputhje me qëllimin që ka SKS. Rezultatet paraqiten në mënyrë të përmbledhur për të gjitha institucionet, për dy kategori të ndara (IAL publike / IAL jo publike), dhe rezultate për institucionet që kanë një pjesëmarrje të konsiderueshme në sondazh në raport me numrin total të studentëve.

Rezultati përfundimtar i SKS në nivel institucional apo kombëtar, analizohet me qëllim vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies sipas fushave dhe indikatorëve. Në bazë të përgjigjeve të dhëna, vlerësimet grupohen në 3 grupe: *Jo mirë* – klasifikohet ai indikator ose fushë vlerësimi kur të paktën 80 % e pyetjeve kanë marrë mendim/vlerësim keq dhe /ose jo mirë, *Mirë* – klasifikohet ai indikator ose fushë vlerësimi kur deri në 60 % e pyetjeve kanë marrë mendim/vlerësim mirë, mjaftueshëm dhe /ose shumë mirë dhe *Shumë mirë* – klasifikohet ai indikator ose fushë vlerësimi kur të paktën 80 % e pyetjeve janë plotësuar me vlerësim maksimal.

Në përfundim të çdo fushe jepet vlerësimi përfundimtar: (*Jo mirë* – kur të paktën 5 fusha vlerësimi janë vlerësuar jo mirë - *Mirë* – kur 6 fusha vlerësimi janë vlerësuar mirë, 5 mirë dhe 1 shumë mirë, 4 mirë dhe 2 shumë mirë, 3 mirë dhe 3 shumë mirë, 2 mirë dhe 4 shumë mirë, 1 mirë dhe 5 shumë mirë. - *Shumë mirë* - kur të 6 fushat e vlerësimit janë vlerësuar shumë mirë.

Faza 1: Në përputhje me metodologjinë e përmirësuar të Sondazhit Kombëtar të Studentëve dhe bazuar në eksperiencën e cikleve të mëparshme (2019 dhe 2022), ASCAL në bashkëpunim me Bordin e Akreditimit (BA) dhe me mbështetjen e MA ka organizuar SKS 2025, duke synuar një proces më gjithëpërfshirës, të standardizuar dhe të besueshëm në mbledhjen dhe analizimin e perceptimeve të studentëve për cilësinë e arsimit të lartë në Shqipëri.

Në Manualin Metodologjik të SKS është parashikuar hartimi i një raporti përmbledhës kombëtar, i cili përmban analizën statistikore të të dhënave për të

gjitha institucionet publike dhe jopublike të arsimit të lartë, si dhe krahasimet ndërmjet tyre në nivel kombëtar. Rezultatet përfundimtare analizohen nga Bordi i Akreditimit dhe Ministria e Arsimit (MAS, publikohen në mënyrë të hapur dhe i vihen në dispozicion institucioneve të arsimit të lartë për përdorim në analizat e tyre të brendshme të cilësisë dhe planifikimin institucional.

Sipas Vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 229, datë 14.12.2024, SKS 2025 është zhvilluar duke ndjekur strukturën e Kodit të Cilësisë dhe është ndërtuar mbi indikatorë të matshëm që reflektojnë fushat me ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e mësimdhënies, të mbështetjes studentore dhe të funksionimit institucional. Pyetësi i SKS 2025 është i ndarë në gjashtë seksione kryesore, të cilat mbulojnë në mënyrë të plotë aspektet akademike, administrative dhe përvojën e përgjithshme të studentëve në institucionin e tyre të studimit.

Në total përfshihen 36 pyetje, të konceptuara në formate të ndryshme (vlerësim nga 1–5, po/jo dhe pyetje të hapura), të cilat synojnë të sigurojnë analizë të kombinuar sasiore dhe cilësore të perceptimeve të studentëve.

- **Seksioni I** – Informacion i përgjithshëm: Ky seksion mbledh të dhëna bazë për profilin e studentit, si: institucioni, fakulteti, niveli i studimeve, viti akademik, gjinia dhe moshja.
Të dhënat e këtij seksioni shërbejnë për grupimin demografik dhe krahasimin e përgjigjeve sipas kategorive të ndryshme të studentëve dhe institucioneve.
- **Seksioni II** – Mësimdhënia dhe mësimnxënia: Këtu vlerësohet cilësia e procesit të mësimdhënies dhe efikasiteti i pedagogëve në shpjegimin e koncepteve, përdorimin e metodave bashkëkohore, lidhjen midis teorisë dhe praktikës, si dhe angazhimi i studentëve në orë.
Pyetjet janë të strukturuar në një shkallë vlerësimi 1–5 (nga “Aspak dakord” në “Plotësisht dakord”) dhe matin përgatitjen profesionale, komunikimin dhe mënyrën e organizimit të mësimdhënies.
- **Seksioni III** – Vlerësimi dhe feedback-u: Ky seksion analizon procesin e vlerësimit të studentëve, duke përfshirë qartësinë e kriterëve të notimit, drejtësinë e vlerësimit, përdorimin e feedback-ut dhe respektimin e integritetit akademik. Ai ndihmon në identifikimin e transparencës në vlerësim, si dhe në matjen e komunikimit pedagog–student në lidhje me performancën dhe përmirësimin akademik.
- **Seksioni IV** – Burimet dhe infrastruktura në funksion të mësimdhënies: Pyetjet në këtë pjesë fokusohen në vlerësimin e mjedisit fizik dhe teknologjik të të nxënës: bibliotekat, laboratorët, pajisjet didaktike, burimet elektronike, platforma e mësimin në distancë dhe aksesin në literaturë. Studentët vlerësojnë gjithashtu cilësinë e shërbimeve mbështetëse dhe aftësinë e institucionit për të ofruar kushte optimale studimi.
- **Seksioni V** – Mbështetja dhe përfshirja e studentëve: Ky seksion mat nivelin e mbështetjes akademike, administrative dhe psikologjike që u ofrohet studentëve nga institucioni, si dhe përfshirjen e tyre në

vendimmarrje përmes strukturave përfaqësuese.

Vlerësohet respektimi i barazisë, komunikimi i hapur me stafin dhe transparenca institucionale. Përmes këtyre pyetjeve, identifikohet ndjenja e përfshirjes dhe e besimit që studentët kanë ndaj institucionit të tyre.

- **Seksioni VI** – Vlerësimi i përgjithshëm për programin dhe institucionin: Në pjesën përmbyllëse, studentët japin gjykimin e përgjithshëm për cilësinë e programit dhe të institucionit ku studiojnë, si dhe për arsimin e lartë në Shqipëri në tërësi. Pyetjet kyçe të këtij seksioni përfshijnë: “Nëse do të kisha mundësi të zgjidhja sërish, do të zgjidhja të njëjtin institucion dhe program studimi. “Si e vlerësoni cilësinë e arsimit të lartë në Shqipëri?”. Këto pyetje shërbejnë si indikatorë sintetikë për të matur kënaqësinë e përgjithshme studentore dhe besimin në sistemin arsimor shqiptar.

Pyetëtori kombinon pyetje me shkallë vlerësimi numerike (likert), pyetje të mbyllura po/jo, si dhe pyetje të hapura për komente dhe sugjerime. Kjo qasje lejon një analizë të integruar statistikore dhe në përmbajtje, duke ofruar si indikatorë kuantitativë për performancën, ashtu edhe komente cilësore që ndihmojnë në interpretimin e thelluar të rezultateve.

Të gjitha pyetjet janë formuluar në mënyrë që të mund të matin perceptimin subjektiv të studentëve për aspektet kryesore të cilësisë, sigurojnë krahasim ndër vite për institucionet dhe të shërbejnë si bazë për përmirësime konkrete të vetë institucioneve.

Sikundër kemi theksuar, të dhënat e mbledhura nga ky pyetësor përdoren për të ndërtuar profilin e cilësisë së arsimit të lartë në vend dhe të çdo institucioni, për të identifikuar tendencat kombëtare dhe për të ndjekur evoluimin e perceptimit të studentëve ndër vite.

SKS 2025 është një mjet thelbësor për vlerësimin sistematik të cilësisë në arsimin e lartë shqiptar. Ai ndihmon në matjen e përvojës reale të studentëve, duke i kthyer ata në zë aktiv në proceset e sigurimit të cilësisë. Falë strukturës së tij të qartë dhe pyetjeve të fokusuara në aspekte konkrete të përvojës universitare, ky instrument siguron të dhëna të besueshme, të krahasueshme dhe të përdorshme për përmirësim institucional dhe politikëbërje në fushën e arsimit të lartë.

Faza 2: Në kuadër të fazës së dytë të zbatimit të SKS 2025, më 25 prill 2025 u shpërnda zyrtarisht pyetëtori i sondazhit nëpërmjet adresave elektronike të studentëve të regjistruar në 38 Institucionet e Arsimit të Lartë të vendit, përkatësisht 14 institucione publike dhe 25 institucione jopublike.

Pyetëtori u bë i aksesueshëm në mënyrë të plotë dhe të sigurt në platformën e dedikuar të ASCAL, duke qëndruar aktiv deri më 2 qershor 2025.

Gjatë gjithë periudhës së plotësimi të sondazhit, ASCAL mbajti komunikim të vazhdueshëm me koordinаторët institucionalë të 38 IAL-ve nëpërmjet sistemit AMS (ASCAL Management System).

Institucionet u informuan periodikisht mbi nivelet e pjesëmarrjes, ndërsa

ASCAL kërkoi nga grupet e punës dhe koordinatorët institucionalë të ndërmerrnin veprime shtesë për sensibilizimin dhe informimin e studentëve në lidhje me rëndësinë e SKS dhe me mënyrën e plotësimit të tij.

Për të garantuar akses të barabartë për të gjithë studentët, ASCAL kërkoi që çdo institucion të vinte në dispozicion laboratorët e informatikës dhe pajisjet kompjuterike për plotësimin e sondazhit.

Megjithatë, SKS 2025 u konceptua si plotësisht elektronik dhe i aksesueshëm nga çdo pajisje elektronike duke përfshirë telefonat inteligjentë, laptopë, tabletë dhe kompjutera personalë, në mënyrë që pjesëmarrja të ishte sa më e gjerë dhe e lehtë për çdo student.

Një element i rëndësishëm i kësaj faze ishte përfshirja aktive e Këshillave Studentorë në procesin e informimit dhe ndërgjegjësimin të studentëve.

ASCAL u kërkoi Këshillave Studentorë që të kontribuonin në përhapjen e informacionit lidhur me qëllimin, rëndësinë dhe vlerën e pjesëmarrjes në sondazh, duke theksuar se SKS 2025 u ofronte të gjithë studentëve mundësinë e parë kombëtare për të shprehur mendimin e tyre në mënyrë të lirë, anonime dhe të mbrojtur nga çdo ndikim institucional.

Në këtë fazë, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit (MA), u zhvilluan gjithashtu fushata informuese dhe promovuese publike në media audiovizive, portale arsimore dhe rrjete sociale, me qëllim sensibilizimin e studentëve dhe rritjen e pjesëmarrjes në sondazh.

Këto aktivitete komunikimi shërbyen për të forcuar transparencën dhe besueshmërinë e procesit, si dhe për të siguruar që çdo student të kishte një mundësi reale për të kontribuar në vlerësimin e cilësisë së arsimit të lartë në institucionin ku ndjek studimet.



Figura 18: Takimet informuese të zhvilluara në institucionet e arsimit të lartë



Figura 19: Takimet informuese të zhvilluara në institucionet e arsimit të lartë

Faza 3: Në fazën e tretë të zhvillimit të Sondazhit Kombëtar të Studentëve 2025 (SKS 2025), grupi i punës i ASCAL ka përfunduar me sukses të gjithë procesin teknik dhe analitik të mbledhjes, verifikimit dhe përpunimit të të dhënave të mbledhura nga pyetësorët e plotësuar nga studentët.

Pas mbylljes së periudhës së plotësimit të sondazhit, u realizua dokumentimi i të dhënave, duke garantuar integritetin, anonimin dhe gjurmueshmërinë metodologjike të procesit.

Analiza e të dhënave është një proces kompleks dhe i detajuar, që kërkon vlerësim të shumëfishtë të informacionit sasior dhe cilësor. Pas përpunimit fillestar, rezultatet janë shqyrtuar, sintetizuar dhe analizuar nga grupi i punës, për t'u përfshirë në Raportin Analitik Kombëtar të SKS 2025.

Në këtë raport, paraqiten fillimisht rezultatet e përgjithshme në nivel kombëtar, ndërsa bashkëlidhur raportit, jepen të dhënat e plota dhe krahasuese për çdo Institucion të Arsimit të Lartë Publik dhe Jopublik, sipas vlerësimeve të dhëna drejtpërdrejt nga studentët.

Ky raport përbën dokumentin zyrtar të analizës kombëtare, që përmbledh rezultatet, tendencat dhe konkluzionet kryesore të sondazhit, duke shërbyer si një instrument referues për analizat e mëtejshme institucionale dhe politikat publike të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. ASCAL është angazhuar në mënyrë të vazhdueshme për sensibilizimin dhe nxitjen e pjesëmarrjes së studentëve, si dhe u ndërmorën disa masa për shtyrjen e afateve dhe komunikimin direkt me IAL-të, pjesëmarrja totale e studentëve në SKS 2025 mbetet ende nën nivelin optimal të dëshiruar veçanërisht në disa institucione për të arritur një përfaqësim plotësisht gjithëpërfshirës.

Në disa IAL, niveli i pjesëmarrjes ka qenë i kënaqshëm, ndërsa në të tjera, sidomos në universitetet me numër të madh studentësh, frekuenca e përgjigjeve rezultoi më e ulët.

ASCAL thekson rëndësinë e bashkëpunimit më të ngushtë me IAL-të dhe studentët, në mënyrë që në ciklet e ardhshme të sondazhit të arrihet një nivel më i lartë përfshirjeje të studentëve.

Bazuar në të dhënat përfundimtare të përpunuara nga tabela e SKS 2025, në sondazh kanë marrë pjesë gjithsej 24.107 studentë nga të gjitha institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri, IAL publike 11.424 studentë ose 47%, IAL jopublike 12.683 studentë ose 53%.

Nëse analizojmë pjesëmarrjen e studentëve në çdo pyetje, rezultatet janë të ndryshme. Në tërësinë e vet, plotësimi i pyetjeve nuk ka qenë detyrues me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të studentëve mbi interesin që duhet të tregojnë në përmbushjen e rolit të tyre si kontribuues dhe vlerësues kryesorë të jetës akademike të një institucioni.

Nga 24.107 studentë që kanë marrë pjesë në sondazh, përqindja mesatare e plotësimit për pyetjet e pyetësorit rezulton mbi 90%, duke reflektuar interes, seriozitet dhe ndërgjegjësim të lartë për rëndësinë e këtij instrumenti në proceset e sigurimit të cilësisë. Shumica e pyetjeve të pyetësorit janë plotësuar nga 90% e studentëve pjesëmarrës, veçanërisht ato që lidhen me mësimdhënien, kompetencën e pedagogëve dhe cilësinë e programeve. Megjithatë ka pyetje në të cilat nuk janë përgjigjur rreth 20% deri 25% e studentëve.

Pyetjet që kërkojnë vlerësim të drejtpërdrejtë (“Aspak dakord”, “Plotësisht dakord”) kanë një nivel shumë të lartë të pjesëmarrjes, çka tregon se studentët janë ndjerë të lirë dhe të sigurt për të dhënë mendimin e tyre.

- Seksioni I (Informacion i përgjithshëm): Ka pjesëmarrjen më të plotë (afër 100%), pasi pyetjet janë objektive dhe të lehta për t’u plotësuar (mosha, fakulteti, cikli i studimit).
- Seksioni II (Mësimdhënia dhe mësimnxënia): Rezulton ndër më të plotësuarit (97–99%), duke dëshmuar se studentët i kushtojnë rëndësi të madhe cilësisë së procesit mësimor dhe rolit të pedagogëve.
- Seksioni III (Vlerësimi dhe feedback-u): Pjesëmarrja është rreth 95%, pak më e ulët se në seksionin e mëparshëm, për shkak të pyetjeve që kërkojnë reflektim mbi drejtësinë e notimit dhe komentet e pedagogëve.
- Seksioni IV (Burimet dhe infrastruktura): Ka një nivel të lartë plotësimi (92–93%), por disi më të ulët në pyetjet që lidhen me burimet digjitale dhe bibliotekat elektronike, një tregues i diferencave ndërmjet institucioneve.
- Seksioni V (Mbështetja dhe përfshirja e studentëve): Pjesëmarrja në këtë seksion është mesatarisht 90–93%. Studentët kanë qenë më të rezervuar në pyetjet që lidhen me përfaqësimin dhe përfshirjen në vendimmarrje, duke reflektuar një perceptim të ndryshëm mbi efektivitetin e strukturave studentore.

- Seksioni VI (Vlerësimi i përgjithshëm): Përfshirja në pyetjet sintetike si “Nëse do të kisha mundësi të zgjidhja sërish...” dhe “Si e vlerësoni cilësinë e arsimit të lartë në Shqipëri” është rreth 88–90%, një nivel i lartë që garanton besueshmëri të analizës përfundimtare.

Në SKS 2025 vihet re se numri mesatar i përgjigjeve të dhëna për pyetje individuale është më i ulët, çka tregon se pjesëmarrja në nivel pyetjeje ka qenë më e kufizuar, ndonëse plotësimi i përgjithshëm i pyetësorit ka mbetur i krahasueshëm me vitet e mëparshme.

Kjo situatë nuk lidhet thjesht me mungesën e interesit nga ana e studentëve, por edhe me nivelin e ulët të motivimit institucional, numrin e lartë të pyetjeve etj. Në disa institucione, adresat elektronike të studentëve të dërguara nga IAL-të rezultuan joaktive ose jo të përditësuara, duke ndikuar drejtpërdrejt në numrin e përgjigjeve të marra.

Ashtu siç ilustron në grafikun e mësipërm, përqindja e studentëve që kanë dhënë përgjigje në raport me numrin e studentëve që kanë marrë e-mail-in dhe me numrin total të studentëve në institucion ndryshon ndjeshëm nga një IAL në tjetrën. Në disa raste, diferencat midis adresave të sakta dhe atyre joaktive kanë rezultuar të konsiderueshme, duke ndikuar në shkallën reale të përfshirjes.

Megjithatë, përmirësime të dukshme janë vërejtur në disa institucione, përfshirë Universitetin e Shkodrës, Universitetin Aldent, Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë, Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, etj., ku pjesëmarrja është e kënaqshme falë një procesi më të mirë koordinimi institucional dhe ndërgjegjësimi studentor.

Nga ana tjetër, pjesëmarrja më e ulët në disa institucione tregon një mundësi për të përmirësuar rezultatet e sondazhit, veçanërisht në analizat krahasuese ndërmjet IAL-ve. Ky identifikim ofron një bazë për ndërmarrjen e veprimeve që rrisin angazhimin e studentëve dhe pjesëmarrjen, duke kontribuar në rezultate më gjithëpërfshirëse dhe të balancuara për çdo institucion.

Rezultatet tregojnë se studentët e IAL-ve jopublike vijojnë të shfaqin vlerësime më pozitive sesa ata të IAL-ve publike një tendencë e qëndrueshme ndër vite por verifikimi i plotë i këtij perceptimi është i vështirë, për shkak të dallimeve në madhësinë, strukturën dhe karakteristikat e studentëve ndërmjet institucioneve. Në përfundim, SKS 2025 ofron një pasqyrë të vlefshme të opinionit studentor për institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri. Për shkak të kompleksitetit të të dhënave dhe variacioneve institucionale, ky raport fokusohet në paraqitjen e rezultateve, përfundimeve dhe statistikave që pasqyrojnë përvojën e studentëve dhe institucionet e tyre, duke ofruar një bazë solide për përmirësime të mëtejshme dhe zhvillime strategjike, pa u thelluar në analiza krahasuese ndërinstitucionale për indikatorë ose tregues të veçantë. Ky qëndrim siguron objektivitetin dhe neutralitetin e analizës, duke e pozicionuar SKS 2025 si një instrument informues e orientues për përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë në vend.

4.2. CILËSIA E MËSIMDHËNIES NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË

Pyetësi i studentëve është ndarë në 7 seksione. Në seksionin 1, fillimisht janë përgatitur pyetjet për çdo institucion. Më pas studentët e çdo institucioni kanë patur të drejtën e përzgjedhjes së fakultetit, programit ku studiojnë, përzgjedhjen e programit, gjinia, moshë. Në vijim në paraqiten rezultatet analitike për çdo seksion për të gjitha institucionet në tërësi dhe në mënyrë krahasuese për institucionet publike dhe jo publike. Në analizën tonë jemi fokusuar në vlerësimin e rezultateve në nivel kombëtar dhe në mënyrë krahasuese ndërmjet institucioneve publike dhe jopublike. Rezultatet individuale për çdo IAL do të vihen në dispozicion për analizë të mëtejshme. Në analizën e të dhënave, çdo pyetje e pyetësorit (variabël) përfaqëson një indikator të perceptimit të studentëve mbi një aspekt të caktuar të procesit mësimor, organizativ ose institucional. Për secilin nga këta tregues, është llogaritur vlera mesatare e vlerësimit për të identifikuar nivelin e kënaqësisë apo të perceptimit pozitiv të studentëve në lidhje me indikatorin përkatës. Kjo llogaritje është bërë veçmas për studentët e institucioneve publike dhe veçmas për studentët e institucioneve jo publike, me qëllim që të mundësohet krahasimi ndërmjet dy kategorive kryesore të sistemit të arsimit të lartë shqiptar dhe më pas është llogaritur mesatarja në nivel kombëtar. Për çdo pyetje të SKS, mesatarja për secilin grup llogaritet me formulën standarde për mesataren aritmetike të një grupi të dhënash. Për disa tregues, nëpërmjet korrelacionit, kemi vlerësuar numerikisht ndikimin në perceptimin e përgjithshëm të cilësisë së arsimit të lartë në Shqipëri.

4.2.1. Seksioni 1, Mësimdhënia dhe mësimnxënia

Pyetjet e Seksionit B, Fusha1, Mësimdhënia dhe mësimnxënia mund të grupohen në katër kategori analitike që reflektojnë aspekte të ndryshme të procesit mësimor:

Kompetenca dhe profesionalizmi i pedagogëve ku pyetjet vlerësojnë aftësinë e profesorëve për të shpjeguar qartë dhe me kompetencë përgatitjen akademike të tyre, respektin dhe marrëdhënien pedagog–student, aftësinë për të përdorur metoda bashkëkohore të mësimdhënies. Këto pyetje matin cilësinë bazë të stafit akademik dhe ndikimin e tyre në përvojën e të nxënës, angazhimi dhe pjesëmarrja e studentëve në mësim etj.

Kategoria e dytë lidhet me mënyrën sesi studentët përfshihen aktivisht në procesin e të nxënës. Nëpërmjet pyetjeve vlerësohet nëse studentët inkurajohen të shprehin mendime, nëse ndihen të stimuluar për të punuar në grup dhe nëse aktivitetet praktike u ndihmojnë për të zbatuar njohuritë teorike. Kjo kategori vlerëson mjedisin e mësimnxënies aktive dhe bashkëpunuese.

Lidhja mes teorisë, praktikës dhe zhvillimit të kompetencave është një tjetër fokus ku një pjesë e pyetjeve kanë për qëllim të matin sa mirë programet e

studimit ndihmojnë studentët të thellohen në koncepte, të zhvillojnë aftësi analitike dhe profesionale, dhe të kuptojnë zbatimin praktik të njohurive të marra. Synimi është matja e efikasitetit të programit dhe mënyra se si mësimdhënia përgatit studentët për tregun e punës.

Motivimi dhe mbështetja në procesin e të nxënit evidentohet në një set pyetjesh ku qëllimi është sa dhe si pedagogët i transmetojnë studentëve njohuritë e nevojshme, mbështetjen që ofrojnë në kuptimin e materialeve mësimore, si dhe ndjenjën e përfshirjes dhe përkatësisë akademike.

Në nivel analitik, Seksioni 1, shërben për të identifikuar forcat dhe dobësitë në procesin e mësimdhënies; matur cilësinë e ndërveprimit pedagog–student; vlerësuar nivelin e përgatitjes dhe përfshirjes së stafit akademik; dhe për të kuptuar sa efektive janë strategjitë mësimore të përdorura për nxitjen e të nxënit aktiv.

Në analizën e rezultateve, përgjigjet e këtij seksioni zakonisht kanë peshën më të madhe në vlerësimin e studentëve për institucionin, pasi përbëjnë përvojën akademike që studentët kanë me programin dhe personelin akademik.

Në vijim paraqiten pyetjet kryesore të këtij seksioni dhe vlerësimet respektive të studentëve. Fillimisht rezultatet janë paraqitur në nivel kombëtar dhe më pas në mënyrë krahasuese për institucionet publike e jopublike.




Figura 20: Kompetenca e personelit akademik në shpjegim




Figura 21: Kompetenca e personelit akademik në shpjegim, sipas llojit të institucionit




Figura 22: Thellimi i koncepteve dhe njohurive




Figura 23: Thellimi i koncepteve dhe njohurive, sipas llojit të institucionit




Figura 24: Inkurajimi i studentëve për të marrë pjesë në aktivitete studimore




Figura 25: Inkurajimi i studentëve për të marrë pjesë në aktivitete studimore, sipas llojit të institucionit




Figura 26: Zbatimi i njohurive në praktikë




Figura 27: Zbatimi i njohurive në praktikë, sipas llojit të institucionit

Në vlerësimin e përgjithshëm, mendimi i studentëve është pozitiv për të 4 treguesit e mësipërm. Sikundër shihet, vlerësimet janë në të njëjtin nivel por ndërkohë, studentët vlerësojnë si më problematike zbatimin e njohurive në praktikë dhe inkurajimin nga ana e personelit akademik për pjesëmarrje në aktivitete studimore.

Në rezultatet e paraqitura, dukshëm vërehet niveli i vlerësimit më të mirë në institucionet jopublike lidhur me kompetencat e personelit akademik krahasuar me vlerësimin në IAL publike.

Konkretisht, për vlerësimin e kompetencave të personelit akademik, vetëm 36.4 % e studentëve në IAL publike, mendojnë se personeli akademik është kompetent, ndërsa po aq përgjithësisht janë dakord me këtë konstatim. Në IAL jopublike, ky rezultat është rreth 62%.

Edhe në vlerësimin e njohurive të thelluara që jepen në programin e studimit, rezulton se studentët në IAL jopublike janë më të kënaqur me rreth 59 % përkundrejt 38 % në institucionet publike. Mbi 5% janë aspak dakord me këtë konstatim.

Në pyetjen mbi nivelin e zbatimit të njohurive teorike në praktikë, sikundër theksuam më herët, rezulton se studentët vlerësojnë më pak zbatimin e njohurive në praktikë. Veçanërisht i dukshëm është ky dallim në institucionet publike ku rreth 12 % e studentëve nuk janë aspak dakord me këtë pohim.

Indikatori	IAL Publike (Mes.)	IAL JoPublike (Mes.)	Koment
------------	--------------------	----------------------	--------

Profesorët janë kompetentë	4.3	4.6	Të dy kategoritë marrin vlerësime të larta; më të larta në IAL jo publike, mendojmë për shkak të kontaktit më të drejtpërdrejtë me studentët.
Mësimi më ndihmon të thellohem në njohuri	4.1	4.5	Studentët e në IAL jo publike ndihen më të stimuluar nga format e mësimit interaktiv dhe aplikativ.
Stafi akademik më inkurajon	4.0	4.4	Lidhje e fortë me motivimin; në IAL publike varion shumë midis fakulteteve.
Programi kombinon teori-praktikë	4.2	4.5	Programet në IAL jo publike janë perceptuar si më të balancuara midis teorisë dhe praktikës.

Për të kuptuar se cili faktor ndikon më shumë në perceptimin e studentëve për cilësinë e arsimit, u llogaritën koeficientet e korrelacionit midis çdo treguesi dhe pyetjes kryesore “Si do ta klasifikoni nivelin e cilësisë së arsimit të lartë në Shqipëri”?

Treguesi	Koef. korrelacioni r (me Cilësia_e_arsi mit të lartë)	Natyra e lidhjes	Interpretim
Profesorët janë kompetentë	$r \approx 0.72$	Shumë e fortë	Kompetenca e pedagogëve është faktori kryesor që formon perceptimin për cilësinë e mësimdhënies.
Mësimi më ndihmon të thellohem në njohuri	$r \approx 0.70$	E fortë	Ndjesia e progresit intelektual përbën dimensionin themelor të kënaqësisë me mësimdhënien.
Stafi më inkurajon	$r \approx 0.66$	E fortë	Motivimi dhe inkurajimi rrisin angazhimin dhe përmirësojnë perceptimin për cilësinë e procesit.
Programi kombinon teori-praktikë	$r \approx 0.59$	Mesatare	Integrimi i përmbajtjes praktike rrit ndjesinë e nevojës dhe aplikimin e njohurive teroike në praktikë studimeve.

Analiza tregon se pjesa më e madhe e studentëve shprehen përgjithësisht dakord ose plotësisht dakord me cilësinë e mësimdhënies dhe kompetencën e stafit akademik, por njëkohësisht evidentohen dy indikatorë problematikë që kërkojnë përmirësim të mëtejshëm:

- Përfshirja e studentëve në aktivitete studimore dhe interaktive (prezantime, ese, ushtrime, punë në grup, etj.), ku niveli i dakordësisë është më i ulët në institucionet publike, duke reflektuar nevojën për metoda më bashkëkohore të mësimdhënies dhe rritje të ndërveprimit me studentët gjatë orëve mësimore.

- Zbatimi i njohurive teorike në praktikë, mbetet sfidë për shumë programe studimi, sidomos në IAL-të publike, ku mungesa e praktikave laboratorike dhe bashkëpunimeve institucionale kufizon përvojën aplikative të studentëve.

Në bazë të këtyre rezultateve, institucionet publike të arsimit të lartë dhe personeli akademik duhet të forcojnë rolin e studentit si pjesëmarrës aktiv në procesin mësimor, duke integruar komponentë praktikë në programet e tyre të studimit. Në përputhje me metodologjinë e SKS dhe standardet e vlerësimit të cilësisë, konkluzioni përfundimtar i Fushës 1 “Mësimdhënia dhe mësimnxënia” për SKS 2025 klasifikohet në nivelin mbi mesatar të kënaqësisë, me tendencë për përmirësim, veçanërisht në aspektin e praktikës profesionale dhe përfshirjes aktive të studentëve në procesin e të nxënës.

4.2.2. Seksioni 2: Vlerësimi dhe feedback-u

Seksioni 2 i pyetësorit të SKS 2025 është fokusuar në indikatorët që lidhen me mënyrën se si realizohet vlerësimi i studentëve, transparenca dhe korrektësia e procesit vlerësues, si dhe mekanizmat e feedback-ut nga ana e stafit akademik dhe institucioneve të arsimit të lartë. Ky seksion synon të masë perceptimin e studentëve për drejtësinë, qartësinë dhe efektivitetin e metodave të vlerësimit të përdorura gjatë procesit të mësimdhënies, si dhe nivelin e komunikimit dhe reflektimit mbi rezultatet e tyre akademike.

Në këtë kuadër, studentëve u është kërkuar të vlerësojnë disa aspekte kyçe të procesit të vlerësimit, përfshirë: Qartësinë e kriterëve të vlerësimit të parashikuara në fillim të lëndës dhe mënyrën se si ato janë komunikuar nga pedagogu, Konsistencën dhe drejtësinë në vlerësim, pra nëse të gjithë studentët janë trajtuar në mënyrë të barabartë dhe pa paragjykime, Koherencën ndërmjet përmbajtjes së lëndës, mënyrës së mësimdhënies dhe instrumenteve të vlerësimit (teste, detyra, projekte, punë praktike etj.), Kthimin e feedback-ut nga pedagogu mbi performancën individuale të studentit, qartësinë dhe vlefshmërinë e këtij feedback-u për përmirësimin e mëtejshëm. disponueshmërinë dhe komunikimin e stafit akademik në rastet kur studentët kërkojnë sqarime apo rivlerësim të notës përfundimtare.

Nëpërmjet analizës së këtij seksioni, synohet të vlerësohet nëse procesi i vlerësimit është transparent, i bazuar në kriterë të paracaktuara, dhe nëse feedback-u i dhënë nga stafi akademik kontribuon realisht në zhvillimin e aftësive akademike dhe profesionale të studentëve. Ky seksion ka rëndësi të veçantë në vlerësimin e cilësisë së procesit mësimor dhe në identifikimin e aspekteve që kërkojnë përmirësim, në mënyrë që të sigurohet një sistem vlerësimi që jo vetëm mat njohuritë, por nxit mendimin kritik, përgjegjësinë individuale dhe përmirësimin e vazhdueshëm të studentëve.

Në vijim po paraqesim vlerësimin e studentëve për këtë seksion:




Figura 28: Metodat e vlerësimit




Figura 29: Korrektësia e vlerësimit




Figura 30: Korrektësia e vlerësimit, sipas llojit të institucionit




Figura 31: Ndhimesa e personelit akademik për të kuptuar lëndën




Figura 32: Ndihmesa e personelit akademik për të kuptuar lëndën, sipas llojit të institucionit




Figura 33: Plagjiatura dhe kopjimi




Figura 34: Plagjiatura dhe kopjimi, sipas llojit të institucionit




Figura 35: Ndihmesa nga personeli akademik, për të marrë me të mirën gjatë studimeve




Figura 36: Ndhimesa nga personeli akademik, për të marrë me të mirën gjatë studimeve, sipas llojit të institucionit




Figura 37: Vlerësimi i drejtë




Figura 38: Vlerësimi i drejtë, sipas llojit të institucionit




Figura 39: Kontakti me personelin akademik




Figura 40: Kontakti me personelin akademik, sipas llojit të institucionit

Në mënyrë krahasuese, të gjithë indikatorët e këtij seksioni, rezultatet janë analizuar në nivel kombëtar dhe janë ndarë sipas institucioneve publike (IAL publike) dhe jopublike (IAL jopublike).

Bazuar në vlerësimet e studentëve, evidentohen disa gjetje kyçe që kërkojnë adresim institucional dhe përmirësim të praktikave të vlerësimit dhe komunikimit akademik.

Në pyetjen *“Metodat e përdorura të vlerësimit testojnë të gjitha njohuritë e marra në programin e studimit”*, studentët në nivel kombëtar janë përgjigjur pozitivisht: 48% Plotësisht dakord, 27% Përgjithësisht dakord. Vetëm rreth 9.9% e tyre nuk janë dakord me këtë pohim.

Në ndarjen sipas tipit të IAL-ve, IAL jopublike kanë përqindje më të lartë të aprovimit ($\approx 29\%$) sesa IAL publike ($\approx 19\%$). Kjo tregon se studentët e IAL jopublike vlerësojnë më shumë mënyrën se si strukturat e vlerësimit reflektojnë përmbajtjen e programeve.

Në IAL publike, 10 % e studentëve kanë shprehur mospërputhje mes përmbajtjes dhe mënyrës së testimit një element që duhet adresuar në strukturat e sigurimit të cilësisë.

Në pyetjen *“Vlerësimi dhe notat që kam marrë kanë qenë korrekte”*, shumica e studentëve janë përgjigjur pozitivisht: 48% Plotësisht dakord, 26% Përgjithësisht dakord, ndërsa vetëm 10% shprehen se nuk janë dakord. Në IAL jopublike, besimi te korrektësia e vlerësimit është dukshëm më i lartë ($\approx 28\%$) krahasuar me IAL publike ($\approx 20\%$). Megjithatë, 13% e studentëve në IAL publike, mendojnë se notat nuk janë të merituar, një tregues që kërkon

rishikim të transparencës në procesin e vlerësimit dhe fuqizim të komisioneve të provimeve.

Në pyetjen *“Marr komente nga profesorët për punën time që më ndihmojnë të kuptoj më mirë lëndën”*, përgjigjet tregojnë një prani pozitive të feedback-ut: 50.9% Plotësisht dakord, 25% Përgjithësisht dakord, vetëm 10% kanë dhënë përgjigje negative. Në IAL jopublike, 30 % e studentëve janë “Plotësisht dakord”, krahasuar me 21 % në IAL publike. Ky diferencim sugjeron se në institucionet jopublike feedback-u pedagogjik është më i personalizuar dhe më i shpeshtë. Në IAL publike, nevoja për mekanizma sistematikë të feedback-ut pas provimeve mbetet thelbësore.

Në pyetjen *“Plagjiatura apo kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga stafi akademik”*, studentët kanë vlerësuar shumë lart ndershmërinë akademike: 65% Plotësisht dakord, 16% Përgjithësisht dakord, vetëm 9% shprehen ndryshe.

Në IAL jopublike, 37% janë “Plotësisht dakord” kundrejt 27% në IAL publike, çka tregon se institucionet jopublike kanë ndoshta mekanizma më të drejtpërdrejtë kontrolli për rastet e plagjiaturës.

Megjithatë, përgjithësisht ky është treguesi më pozitiv i fushës, që pasqyron kulturë të mirë akademike në të dy kategoritë e institucioneve.

Në pyetjen *“Nuk marr mjaftueshëm ndihmë nga profesorët e mi për të dhënë më të mirën në studimet e mia”*, rreth 41% janë “Aspak dakord” (pra mendojnë se marrin ndihmë të mjaftueshme), 27% janë neutralë ose pjesërisht dakord, ndërsa 13% në të dy kategoritë (IAL publike dhe IAL jopublike) pohojnë se nuk marrin mjaftueshëm mbështetje.

Indikatori	IAL Publike (Mes.)	IAL Jopublike (Mes.)	Komente
Metodat e përdorura të vlerësimit testojnë të gjitha njohuritë e marra në programin e studimit.	4.0	4.3	Studentët në të dy llojet e institucioneve janë përgjithësisht dakord; në IAL jopublike metodat perceptohen më gjithëpërfshirëse dhe të përshtatura me përmbajtjen e programeve.
Vlerësimi dhe notat që kam marrë kanë qenë korrekte.	4.0	4.3	Korrektësia e vlerësimit perceptohet më e lartë në IAL jopublike; në IAL publike evidentohet mospërputhje në 10–12% të rasteve
Marr komente nga profesorët për punën time, që më ndihmojnë të kuptoj më mirë lëndën.	3.9	4.4	Feedback-u nga profesorët është i pranishëm, por në IAL publike mbetet i fragmentuar dhe jo i strukturuar; IAL jopublike tregojnë përfshirje më aktive të personelit akademik.
Plagjiatura apo kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga stafi akademik.	4.4	4.6	Integriteti akademik perceptohet shumë lartë në të dy llojet e institucioneve; diferencë e vogël pozitive për IAL jopublike, që zbaton më strikt rregullat etike.

Marr ndihmë të mjaftueshme nga profesorët e mi për të dhënë më të mirën në studimet e mia.	3.8	4.1	Rreth 13% e studentëve në të dyja kategoritë ndihen të pambështetur; rezultati tregon nevojë për mentorim më aktiv dhe sistem feedback-u më të shpeshtë.
--	-----	-----	--

Për të kuptuar se cili faktor ndikon më shumë në perceptimin e studentëve për cilësinë e arsimit, u llogaritën koeficientët e korrelacionit midis çdo treguesi dhe pyetjes kryesore *“Si do ta klasifikoni nivelin e cilësisë së arsimit të lartë në Shqipëri”*

Treguesi	Koef. korrelacioni r (me Cilësisa_e_AL)	Natyra e lidhjes	Interpretim
Metodat e përdorura të vlerësimit testojnë të gjitha njohuritë e marra në programin e studimit.	$r \approx 0.73$	Shumë e fortë pozitive	Studentët që perceptojnë metodat e vlerësimit si gjithëpërfshirëse dhe të drejta, kanë më shumë prirje të vlerësojnë pozitivisht cilësinë e arsimit. Ky është treguesi më i lidhur me perceptimin e drejtësisë dhe objektivitetit akademik.
Vlerësimi dhe notat që kam marrë kanë qenë korrekte.	$r \approx 0.70$	E fortë pozitive	Perceptimi për korrektësinë e vlerësimit ndikon drejtpërdrejt në besimin e studentëve te procesi mësimor dhe në përvojën e përgjithshme akademike.
Marr komente nga profesorët për punën time, që më ndihmojnë të kuptoj më mirë lëndën.	$r \approx 0.67$	E fortë pozitive	Feedback-u i strukturuar nga profesorët ndikon në thellimin e njohurive dhe përmirëson ndjeshëm perceptimin e studentëve për cilësinë e mësimdhënies.
Plagjiatura apo kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga stafi akademik.	$r \approx 0.61$	E fortë mesatare pozitive	Zbatimi i rregullave të ndershmërisë akademike kontribuon në rritjen e besueshmërisë dhe seriozitetit të procesit mësimor.
Marr ndihmë të mjaftueshme nga profesorët e mi për të dhënë më të mirën në studimet e mia.	$r \approx 0.58$	Mesatare pozitive	Ndihma akademike e vazhdueshme është e rëndësishme për përmirësimin e cilësisë, megjithatë efekti i saj është më indirekt krahasuar me treguesit e tjerë.

Rezultatet e përftuara nga analiza e përgjigjeve të studentëve në nivel kombëtar tregojnë një nivel të përgjithshëm të kënaqësisë mesatar deri të mirë për indikatorët që lidhen me procesin e vlerësimit, transparencën në notim dhe komunikimin pedagogjik.

Megjithatë, krahasimi ndërmjet institucioneve publike dhe jopublike nxjerr në pah dallime të rëndësishme, si në intensitetin e praktikave të feedback-ut, ashtu edhe në perceptimin për drejtësinë dhe korrektësinë e vlerësimit.

Në institucionet publike, mesatarja e përgjithshme e kënaqësisë së studentëve është 4.02 (në shkallën nga 1–5), çka tregon kënaqësi të lartë, por jo të njëtrajtshme midis fakulteteve dhe programeve, shpërndarje të gjerë të vlerësimeve, që reflekton shumëllojshmërinë e praktikave të mësimdhënies dhe të feedback-ut brenda të njëjtit institucion.

Studentët në IAL publike vlerësojnë lartë profesionalizmin dhe kompetencën e stafit akademik, por evidentojnë probleme të qëndrueshme në mungesën e feedback-ut të rregullt dhe të personalizuar pas provimeve ose detyrave, perceptimin për mospërputhje mes përpjekjes së studentit dhe notës së marrë dhe mungesën e ndihmës së mjaftueshme nga pedagogët për studentët që kanë vështirësi në përvetësimin e lëndës. Ky variacion sugjeron se brenda IAL publike ekziston diferencim i brendshëm i kulturës institucionale të vlerësimit, ku disa fakultete kanë standarde të larta, ndërsa të tjerat mbeten në nivel mesatar. Në këtë kontekst, forcimi i mekanizmave të sigurimit të brendshëm të cilësisë (komisionet e provimeve, analiza e rezultateve të vlerësimeve, mbledhjet e feedback-ut me studentët) është domosdoshmëri për harmonizimin e praktikave.

Në IAL jopublike, mesatarja e përgjithshme e vlerësimeve është 4.34, që tregon një kënaqësi më të lartë dhe më të qëndrueshme në të gjithë treguesit dhe një nivel uniformiteti më të madh në standardet e vlerësimit dhe feedback-ut. Studentët e këtyre institucioneve raportojnë se metodat e vlerësimit janë më të lidhura me përmbajtjen e lëndës dhe objektivat e programit, komunikimi me pedagogët është më i hapur dhe efektiv, dhe feedback-u është më i personalizuar, duke kontribuar në rritjen e ndjesisë së përfshirjes dhe motivimit. Diferencat e vogla tregojnë një stabilitet institucional më të mirë, që lidhet me përmasat më të vogla të klasave, monitorimin më të afërt të procesit të mësimdhënies, dhe zbatimin e rregullt të politikave të sigurimit të cilësisë në vlerësim dhe mbështetje akademike.

Nga sa më sipër, IAL jopublike kanë vlerësime më të larta për shkak të dimensionit më të vogël të klasave, komunikimit më të drejtpërdrejtë dhe feedback-ut më të strukturuar.

IAL publike shfaqin stabilitet të mirë në etikë dhe integritet, por ka sfida në feedback-un sistematik dhe mentorimin individual.

Në të dy rastet, studentët kërkojnë më shumë transparencë në vlerësim dhe më shumë komunikim pas provimeve. Feedback-u i profesorëve mbetet pika e dobët më e dukshme, që ndikon negativisht në perceptimin e përgjithshëm për cilësinë e mësimdhënies, sidomos në IAL publike.

Përmirësimi i mëtejshëm duhet të fokusohet në:

- zhvillimin e mekanizmave të qëndrueshëm të feedback-ut pas vlerësimit;
- trajnime të stafit akademik për metoda komunikimi me studentët;

- dhe rritjen e mentorimit individual për studentët me performancë më të ulët.

Niveli i përgjithshëm i kënaqësisë për fushën “Vlerësimi dhe feedback-u” është mbi mesatar.

4.2.3. Seksioni 3: Burimet në funksion të mësimdhënies

Në Fushën 4, studentëve u është kërkuar të japin vlerësime për burimet e institucioneve në funksion të mësimdhënies si literatura bazë dhe e rekomanduar, aksesit apo cilësia e bibliotekës online e fizike, infrastruktura dhe logjistika e IT, etj.

Edhe për këtë fushë, indikatorët e mësipërm janë analizuar në mënyrë krahasuese midis institucioneve publike e jopublike. Rezultatet përmbledhëse jepen në grafikët e mëposhtëm.

Ka disa tregues ku cilësia e tyre në IAL publike vlerësohet më pak se në ato jopublike. Veçanërisht cilësia e klasave, cilësia/sasia e pajisjeve IT, aksesit në bibliotekën fizike dhe atë digjitale, libraritë online etj, tregon se ka ende nevojë për përmirësime të këtyre treguesve veçanërisht në IAL publike.




Figura 41: Infrastruktura e klasave




Figura 42: Infrastruktura e klasave, sipas llojit të institucionit




Figura 43: Infrastruktura e pajisjeve logjistike dhe IT




Figura 44: Infrastruktura e pajisjeve logjistike dhe IT, sipas llojit të institucionit




Figura 45: Aksesin dhe cilësia e bibliotekës




Figura 46: Aksesin dhe cilësia e bibliotekës, sipas llojit të institucionit




Figura 47: Aksesin dhe cilësia e bibliotekës digjitale




Figura 48: Aksesin dhe cilësia e bibliotekës digjitale, sipas llojit të institucionit




Figura 49: Literatura në bibliotekë




Figura 50: Literatura në bibliotekë, sipas llojit të institucionit

Bazuar në rezultatet e paraqitura më sipër, janë analizuar perceptimet e studentëve lidhur me infrastrukturën fizike dhe logjistike që mbështet procesin e mësimdhënies, si dhe aksesin në burimet mësimore, përfshirë bibliotekën tradicionale dhe digjitale. Rezultatet janë paraqitur në nivel kombëtar dhe ndarë sipas tipit të institucionit (publik/jopublik).

Rreth 49% e studentëve në nivel kombëtar janë plotësisht dakord që klasat ofrojnë kushte të mira mësimore.

IAL jopublike (31%) japin vlerësime dukshëm më të larta se IAL publike (17%) për cilësinë e mjediseve mësimore. Vetëm 6 -7% e studentëve në IAL publike nuk janë dakord, çka tregon nivel të pranueshëm, por jo të njëtrajtshëm.

Institucionet jopublike kanë investuar më shumë në modernizimin e ambienteve të mësimi, duke siguruar ndriçim, ngrohje dhe kushte më të mira për zhvillimin e orëve mësimore. Në IAL publike, sfidat mbeten kryesisht në mirëmbajtjen dhe rinovimin e infrastrukturës ekzistuese.

Rreth 46% e studentëve janë plotësisht dakord se kanë infrastrukturë të mjaftueshme IT në dispozicion, ndërsa 10% shprehen “aspak dakord”. IAL jopublike (30%) vlerësohen dukshëm më lart se IAL publike (15%), ndërkohë që në IAL publike rreth 8% e studentëve shprehen të pakënaqur me sasinë dhe funksionalitetin e pajisjeve. Institucionet jopublike ofrojnë laboratorë më të përditësuar dhe akses më të mirë në internet, ndërsa në shumë IAL publike pajisjet përdoren në mënyrë të kufizuar për shkak të fluksit të studentëve.

Në nivel kombëtar, rreth 50 % e studentëve janë plotësisht dakord me cilësinë e bibliotekës, ndërsa 9% shprehen të pakënaqur. IAL jopublike japin vlerësime dukshëm më të larta krahasuar me IAL publike çka tregon se bibliotekat e

institucioneve jopublike ofrojnë më shumë akses, orare fleksibël dhe kushte fizike më komode.

IAL publike vuajnë ende nga mungesa e hapësirave të mjaftueshme për lexim, ndërsa bibliotekat në IAL jopublike janë më të digjitalizuar dhe më afër nevojave të studentëve.

Treguesi	IAL Publike (Mes.)	IAL Jopublike (Mes.)	Komente
Cilësia e klasave	4.0	4.4	Mjediset më moderne në IAL jopublike ndërsa në IAL publike kërkohet mirëmbajtje infrastrukturore.
Pajisjet IT/logjistika	3.9	4.5	Ka diferencë e qartë në aksesin dhe cilësinë e pajisjeve laboratorike.
Biblioteka fizike	4.1	4.4	Studentët në IAL jopublike kanë më shumë mundësi leximi dhe orare fleksibël.
Biblioteka digjitale	3.8	4.2	IAL publike kanë akses të kufizuar në databaza dhe bibliotekat ndërkombëtare
Literatura bazë	4.0	4.3	Diferencë e moderuar. IAL jopublike përditësojnë më shpesh tekstet dhe referencat.

Për të kuptuar se cilat burime fizike dhe logjistike kanë ndikimin më të madh në perceptimin e studentëve për cilësinë e arsimit të lartë, u llogaritën koeficientet e korrelacionit midis secilit tregues të këtij seksioni dhe pyetjes përfundimtare *“Si do ta klasifikoni nivelin e cilësisë së arsimit të lartë në Shqipëri?”* Rezultatet e analizës tregojnë se faktorët e infrastrukturës dhe burimeve digjitale kanë ndikim të ndryshëm mbi perceptimin e përgjithshëm të cilësisë, duke reflektuar dallime midis institucioneve publike dhe jo publike.

Treguesi	Koef. korrelacioni r (me Cilësia_e_AL)	Natyra e lidhjes	Interpretim
Jam i/e kënaqur me cilësinë e klasave në institucionin tim.	$r \approx 0.68$	E fortë pozitive	Cilësia e mjediseve fizike të mësimi ka ndikim të drejtpërdrejtë në perceptimin e cilësisë së arsimit. Studentët që studiojnë në ambiente të mirëorganizuara, të pastra dhe të pajisura mirë, shprehin nivele më të larta kënaqësie me arsimin e lartë në tërësi.
Jam i/e kënaqur me cilësinë/sasinë e pajisjeve logjistike të IT në institucionin tim.	$r \approx 0.72$	Shumë e fortë pozitive	Infrastruktura IT është ndër treguesit më përcaktues të perceptimit të cilësisë. Studentët që kanë akses të mirë në pajisje kompjuterike, laboratorë funksionalë dhe internet të qëndrueshëm, vlerësojnë më lart cilësinë e mësimdhënies dhe të arsimit në tërësi.

Jam i/e kënaqur me aksesin dhe cilësinë e bibliotekës në institucionin tim.	$r \approx 0.66$	E fortë pozitive	Aksesi në bibliotekë dhe cilësia e shërbimeve biblioteka lidhen ngushtë me mbështetjen akademike dhe ndihmojnë studentët të zhvillojnë aftësi kërkimore. Institucionet me hapësira bibliotekare të modernizuara dhe orare të zgjatura për lexim kanë perceptim më të lartë cilësie.
Jam i/e kënaqur me aksesin dhe cilësinë e bibliotekës dixhitale (online).	$r \approx 0.64$	E fortë mesatare pozitive	Disponimi i burimeve online (databaza shkencore, revista elektronike, libra elektronikë) ndikon në mënyrë të qëndrueshme në perceptimin e cilësisë. Studentët në IAL jopublike që kanë akses më të mirë në këto burime, japin vlerësime më të larta për arsimin e lartë.
Jam i/e kënaqur me literaturën bazë dhe të rekomanduar që disponon biblioteka e institucionit.	$r \approx 0.59$	Mesatare pozitive	Aksesi në literaturë të përditësuar përbën një faktor të rëndësishëm për cilësinë e mësimdhënies, por efekti i tij është më i kufizuar krahasuar me mjediset dhe teknologjinë mësimore. Studentët shpesh kërkojnë materiale më të reja dhe më të përshtatshme për lëndët e tyre.

Rezultatet e përftuara nga analiza e përgjigjeve të studentëve në nivel kombëtar tregojnë një nivel të përgjithshëm të kënaqësisë mesatar deri të mirë për indikatorët që lidhen me infrastrukturën fizike, burimet teknologjike dhe logjistike që mbështesin procesin e mësimdhënies.

Megjithëse studentët shprehen përgjithësisht të kënaqur me kushtet e ofruara, krahasimi ndërmjet institucioneve publike dhe jopublike nxjerr në pah diferenca të qarta në modernizimin e infrastrukturës, aksesin në teknologji, dhe burimet e bibliotekave fizike e digjitale.

Niveli i përgjithshëm i kënaqësisë për fushën “Burimet në funksion të mësimdhënies” është mesatar. Ky rezultat tregon se infrastruktura dhe burimet logjistike e akademike mbështesin në mënyrë të mirë procesin e mësimdhënies në Shqipëri, por ka ende hapësirë për përmirësim në aspektin teknologjik, digjital dhe të aksesit në literaturë bashkëkohore.

4.2.4. Seksioni 4: Organizimi dhe realizimi i programeve

Në vlerësimin e Seksionit 4 “*Organizimi dhe realizimi i programeve të studimit*”, studentëve u është kërkuar të shprehin mendimin e tyre për aspekte të ndryshme mbi përmbajtjen e programeve të studimit, ngarkesën mësimore dhe organizimin e veprimtarive akademike.

Në këtë kuadër, studentët janë pyetur për nivelin e dakordësisë për disa aspekte kyçe të organizimit akademik, përfshirë:

Qartësinë e pritshmërive të të nxënit që në fillim të çdo lënde, si përcaktohen dhe komunikohen objektivat mësimore nga pedagogët dhe departamentet përkatëse, përshtatshmërinë e përmbajtjes së lëndëve me objektivat e programit dhe nëse temat dhe modulet janë në përputhje me kompetencat që studenti duhet të arrijë në fund të studimeve;

Ngarkesën dhe shpërndarjen e orëve mësimore gjatë semestrit, për të vlerësuar nëse planifikimi i leksioneve, seminareve dhe praktikave është i balancuar dhe i realizueshëm;

Zhvillimin e veprimtarive mësimore në përputhje me planin mësimor që lidhet me respektimin e programit dhe orareve akademike. Organizimin e përgjithshëm dhe funksionimin normal të programit të studimit.

Rezultatet janë paraqitur në mënyrë grafike dhe krahasuese IAL publike dhe IAL jopublike:




Figura 51: Pritshmëritë e të nxënit




Figura 52: Pritshmëritë e të nxënit, sipas llojit të institucionit




Figura 53: Përmbajtja e lëndëve




Figura 54: Përmbajtja e lëndëve, sipas llojit të institucionit




Figura 55: Ngarkesa dhe orari i mësimit




Figura 56: Ngarkesa dhe orari i mësimit, sipas llojit të institucionit




Figura 57: Veprimtaritë mësimore




Figura 58: Veprimtaritë mësimore, sipas llojit të institucionit




Figura 59: Organizimi dhe funksionimi i programit të studimit




Figura 60: Organizimi dhe funksionimi i programit të studimit, sipas llojit të institucionit

Në mënyrë krahasuese për të gjithë indikatorët e Seksionit 4, rezultatet në nivel kombëtar tregojnë se studentët vlerësojnë pozitivisht mënyrën se si janë organizuar dhe realizuar programet e studimit, me diferenca të dukshme ndërmjet institucioneve publike dhe jopublike.

Pjesa më e madhe e studentëve (mbi 70%)² shprehen “Plotësisht dakord” ose “Përgjithësisht dakord” për të gjithë treguesit, duke reflektuar një perceptim të mirë për organizimin e përgjithshëm akademik.

Rreth 77% e studentëve në nivel kombëtar janë dakord që pritshmëritë e të nxëniet përcaktohen qartë që në fillim të çdo lënde.

Në IAL jopublike, ky tregues merr vlerësim më të lartë (rreth 30.5% “plotësisht dakord” kundrejt 19.6% në IAL publike). Kjo tregon se komunikimi fillestar me studentët dhe transparenca në objektivat e të nxëniet janë më të konsoliduara në IAL jopublike, ndërsa në IAL publike ka ende hapësirë për përmirësim në standardizimin e mënyrës së prezantimit të programeve dhe syllabuseve.

Një ndër treguesit më pozitivë ku rreth 78% e studentëve janë dakord se përmbajtja e lëndëve, është në përputhje me objektivat e programit.

Diferencat ndërmjet IAL publike dhe IAL jopublike janë të vogla, por IAL jopublike kanë një avantazh të lehtë (31% “plotësisht dakord” kundrejt 21% në IAL publike).

Rezultatet tregojnë se programet janë të strukturuar por nevojitet më shumë përditësim i përmbajtjes dhe koordinim ndërmjet lëndëve për të shmangur mbivendosjet apo boshllëqet.

Shumica e studentëve mendojnë se ngarkesa dhe oraret janë të realizueshme dhe të shpërndara mirë gjatë semestrit.

Rreth 83% e studentëve janë dakord se veprimtaritë mësimore (leksione, seminare, detyra kursi, praktikë) zhvillohen në përputhje me planin mësimor. Diferenca midis institucioneve është më e dukshme: IAL jopublike arrijnë 35% “plotësisht dakord”, kundrejt 25% në IAL publike.

Sikundër në pyetjet e tjera, edhe në këtë seksion, studentët e IAL jopublike, japin një vlerësim më të lartë se në institucionet publike.

Treguesi	IAL Publike (Mes.)	IAL jopublike (Mes.)	Komente
Pritshmëritë e të nxëniet janë të përcaktuara qartë që në fillim të çdo lënde	4.1	4.5	Studentët e IAL jopublike raportojnë transparenca më të madhe në komunikimin e objektivave mësimore dhe qartësi të syllabus-eve. Në IAL publike, megjithëse niveli i dakordësisë është i mirë, kërkohet standardizim në mënyrën e prezantimit të pritshmërive dhe kriterëve të vlerësimit.
Lëndët dhe përmbajtja e tyre janë të përshtatshme për programin e studimit	4.2	4.6	Treguesi më i fortë i këtij seksioni. Programet në IAL jopublike perceptohen më koherente dhe të përditësuara me nevojat e tregut të punës. Në IAL publike, studentët theksojnë nevojën për rishikim periodik të përmbajtjeve dhe balancim midis teorisë dhe praktikës.

² Analiza është kryer mbi numrin e studentëve që janë përgjigjur pyetjeve.

Ngarkesa dhe oraret e mësimit janë të realizueshme dhe të shpërndara mirë gjatë semestrit	3.9	4.3	Diferencë e dukshme ndërmjet institucioneve: studentët në IAL jopublike janë më të kënaqur me menaxhimin e orareve dhe shpërndarjen e ngarkesës. Në IAL publike, ngarkesa perceptohet si e lartë dhe jo gjithmonë e koordinuar me afatet e provimeve dhe detyrave.
Veprimtaritë mësimore (leksione, seminare, detyra kursi, praktikë, punë individuale) zhvillohen në përputhje me planin mësimor	4.3	4.6	Studentët në IAL jo publike konfirmojnë përputhje më të madhe ndërmjet planifikimit dhe zhvillimit real të mësimdhënies. Në IAL publike, devijimet nga oraret apo reduktimet e orëve praktike janë më të shpeshta.
Programi është i organizuar mirë dhe funksionon normalisht, pa probleme	4.1	4.5	Tregues me ndikim të drejtpërdrejtë në perceptimin e cilësisë së arsimit. IAL jopublike shfaqin stabilitet më të lartë organizativ dhe koordinim më të mirë ndërmjet departamenteve. Në IAL publike, ngarkesa administrative ndikojnë në eficiencën e zbatimit të programeve.

Për të kuptuar se cilët faktorë ndikojnë më shumë në mënyrën se si studentët perceptojnë cilësinë e arsimit të lartë në Shqipëri, u llogaritën koeficientët e korrelacionit midis secilit tregues të këtij seksioni dhe pyetjes përfundimtare të pyetësorit: “Si do ta klasifikoni nivelin e cilësisë së arsimit të lartë në Shqipëri?”. Rezultatet e korrelacionit tregojnë një lidhje të fortë pozitive midis perceptimit të organizimit të programeve dhe vlerësimit për cilësinë e përgjithshme të arsimit. Kjo tregon se mënyra se si planifikohen, menaxhohen dhe realizohen programet e studimit ndikon drejtpërdrejt në përvojën e studentit dhe në bindjen e tij për cilësinë institucionale.

Treguesi	Koef. korrelacioni r (me “Cilësia e arsimit të lartë”)	Natyra e lidhjes	Interpretim
Pritshmëritë e të nxënësve janë të përcaktuara qartë që në fillim, për çdo lëndë në programin tim të studimit.	$r \approx 0.71$	Shumë e fortë pozitive	Qartësia e objektivave të të nxënësve është një ndër faktorët më përcaktues të perceptimit të cilësisë. Studentët që kanë pritshmëri të qarta për rezultatet e të nxënësve ndihen më të orientuar dhe më të kënaqur me strukturën akademike.
Lëndët dhe përmbajtja e tyre janë të përshtatshme për programin tim të studimit.	$r \approx 0.74$	Shumë e fortë pozitive	Koherenca ndërmjet përmbajtjes së lëndëve dhe objektivave të programit rrit ndjeshëm besimin e studentëve se po ndjekin një program të strukturuar dhe të vlefshëm profesionalisht.

Ngarkesa dhe oraret e mësimit janë të realizueshme dhe të shpërndara mirë gjatë semestrit.	$r \approx 0.64$	E fortë pozitive	Balanca e ngarkesës mësimore ndikon në perceptimin e drejtësisë dhe menaxhimit të procesit akademik. Studentët që e konsiderojnë ngarkesën si të arsyeshme, e vlerësojnë më lart cilësinë e studimeve.
Veprimtaritë mësimore (leksione, seminare, detyra kursi, praktikë, punë individuale) zhvillohen në përputhje me planin mësimor.	$r \approx 0.69$	E fortë pozitive	Përputhshmëria ndërmjet planifikimit dhe zbatimit real të veprimtarive mësimore është tregues i organizimit të mirë dhe disiplinës institucionale, elementë që ndikojnë ndjeshëm në perceptimin e cilësisë.
Programi është i organizuar mirë dhe funksionon normalisht, pa probleme.	$r \approx 0.76$	Shumë e fortë pozitive	Ky është treguesi që ndikon më drejtpërdrejt në perceptimin e përgjithshëm për cilësinë e arsimit. Studentët që e konsiderojnë programin e tyre të qëndrueshëm dhe të menaxhuar mirë kanë nivel më të lartë besimi të institucionit dhe sistemi arsimor në tërësi.

Rezultatet tregojnë se të gjithë treguesit e këtij seksioni janë ndër faktorët më të rëndësishëm që formojnë perceptimin e cilësisë së arsimit të lartë në Shqipëri. Koherenca e programeve dhe përmbajtja akademike ka lidhjen më të fortë me perceptimin e cilësisë, duke reflektuar rolin e kurrikulës si bazë e përvojës studentore. Stabiliteti dhe organizimi i përgjithshëm i programit është faktori që ndikon më shumë në ndjesinë e “besueshmërisë institucionale” dhe përgatitjes së studentëve për tregun e punës.

Qartësia e objektivave të të nxëniet përmirëson ndjeshëm transparencën dhe pritshmëritë realiste të studentëve për rezultatet akademike. Ngarkesa mësimore dhe zbatimi i planit mësimor janë tregues të lidhur me efektivitetin operacional dhe menaxhimin akademik të institucioneve.

Në IAL jopublike, lidhjet janë më të forta dhe më të qëndrueshme në të gjithë treguesit, gjë që tregon një strukturë më të balancuar dhe organizim më efikas të programeve të studimit.

Në IAL publike, rezultatet janë gjithashtu pozitive, por me variacion më të madh midis fakulteteve, çka sugjeron diferenca të brendshme në menaxhimin akademik dhe planifikimin semestral.

Seksioni 4 rezulton të ketë një lidhje më të fortë me perceptimin e përgjithshëm të cilësisë së arsimit të lartë. Programet e organizuara mirë, të qarta në objektiva, të përputhshme me planin mësimor dhe të balancuara në ngarkesë, përbëjnë bërthamën e cilësisë së përjetuar nga studentët.

Sikundër shihet, seksioni “*Organizimi dhe realizimi i programeve*”, rezulton të me vlerësim të mirë në pothuaj të gjithë treguesit e vlerësimit.

4.2.5. Seksioni 5: Mbështetja dhe zëri i studentëve

Seksioni 5 i pyetësorit të SKS 2025 është fokusuar në indikatorët që lidhen me mbështetjen akademike, administrative dhe psikologjike të studentëve, si dhe me pjesëmarrjen e tyre aktive në jetën institucionale dhe proceset vendimmarrëse të universitetit. Ky seksion synon të masë perceptimin e studentëve për mënyrën se si institucionet e arsimit të lartë u përgjigjen nevojave të tyre gjatë studimeve dhe sa i fuqishëm është zëri i studentëve në proceset e përmirësimit të cilësisë.

Nëpërmjet Seksionit 5, synohet të vlerësohet cilësia e mbështetjes akademike që ofrojnë pedagogët dhe strukturat ndihmëse të universitetit (zyrat e studentëve, tutorët, koordinatorët akademikë), mbështetja administrative dhe informacionin që studentët marrin lidhur me proceset studimore (orare, provime, detyrime financiare, praktika, mobilitete etj.), disponueshmërinë e pedagogëve dhe stafit akademik për konsultime jashtë orëve të mësimi, kujdesin institucional për mirëqenien psikologjike dhe sociale të studentëve dhe mundësitë që u jepen studentëve për të shprehur mendimin e tyre, përfshirë pjesëmarrjen në organizata studentore, këshilla fakultetesh dhe mekanizma institucionale të përfaqësimit.

Synimi final në këtë seksion është të vlerësojë në ç'masë institucionet e arsimit të lartë janë të orientuara drejt studentit, studentët ndihen të dëgjuar, të përfaqësuar dhe të mbështetur në mënyrë të drejtë e të barabartë, struktura organizative dhe akademike e institucionit garanton një mjedis të përshtatshëm për të nxënë, zhvillim personal dhe përfshirje aktive në jetën universitare dhe nëse mekanizmat ekzistues të komunikimit dhe feedback-ut funksionojnë realisht si instrumente për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.

Të vlerësohet jo vetëm sa mirë organizohet procesi i mësimdhënies, por edhe sa i mbështetur dhe i përfshirë ndihet studenti gjatë gjithë ciklit të studimeve.

Rezultatet e këtij seksioni ndihmojnë institucionet të vlerësojnë efektivitetin e mekanizmave të komunikimit dhe përfaqësimit, dhe të ndërmarrin masa për forcimin e kulturës së dialogut dhe bashkëpunimit midis studentëve dhe strukturave drejtuese të IAL-ve. Në vijim paraqiten rezultatet e këtij seksioni në mënyrë grafike:




Figura 61: Liria e shprehjes së mendimit




Figura 62: Liria e shprehjes së mendimit, sipas llojit të institucionit




Figura 63: Trajtimi i barabartë i studentëve




Figura 64: Trajtimi i barabartë i studentëve, sipas llojit të institucionit




Figura 65: Marrja në konsideratë e pikpamjeve dhe opinionit të studentëve




Figura 66: Marrja në konsideratë e pikpamjeve dhe opinionit të studentëve, sipas llojit të institucionit




Figura 67: Informimi i studentëve mbi të drejtat dhe detyrimet




Figura 68: Informimi i studentëve mbi të drejtat dhe detyrimet, sipas llojit të institucionit

Rezultatet tregojnë se studentët në nivel kombëtar vlerësojnë pozitivisht mjedisin e sigurisë dhe lirisë së shprehjes në IAL, me një mesatare kombëtare prej 4.26/5.

Megjithatë, ekzistojnë diferenca të dukshme ndërmjet institucioneve publike dhe jopublike, si në qartësinë e komunikimit, ashtu edhe në përfshirjen e studentëve në vendimmarrje.

IAL jopublike ofrojnë një mjedis më miqësor dhe interaktiv, ku komunikimi student - pedagog është më i drejtpërdrejtë dhe reagimi institucional ndaj shqetësimeve më i shpejtë.

IAL publike, megjithëse ruajnë standarde të larta akademike, vuajnë nga burokracia e brendshme, që kufizon ndonjëherë aksesin e studentëve në informacion dhe në ndikimin real mbi politikatat e fakultetit.

IAL jopublike shfaqin një kulturë më të zhvilluar komunikimi dhe bashkëpunimi me studentët, ku mekanizmat e feedback-ut janë më të qartë dhe funksionalë. IAL publike kanë bërë përparime në sigurimin e mjediseve të hapura, por mbeten të ndikuara nga struktura hierarkike dhe mungesa e kanaleve efektive të komunikimit horizontal.

Në të dy kategoritë, studentët kërkojnë më shumë pjesëmarrje në përmirësimin e programeve dhe politikave akademike, si dhe sisteme transparente informimi që u mundësojnë të ndihen të përfaqësuar realisht në jetën universitare.

Treguesi	IAL Publike (Mes.)	IAL jopublike (Mes.)	Komente
Ekziston një mjedis i sigurt ku të gjithë janë të lirë të shprehin mendimin e tyre	4.1	4.5	Studentët në IAL jopublike ndihen më të lirë për të shprehur mendime kritike ndaj stafit apo administratës. Në IAL publike ka përmirësim, por prania e hierarkive akademike ende ndikon në vetëpërmbytjen e studentëve.
Të gjithë studentët trajtohen në mënyrë të barabartë në program dhe institucion	4.0	4.4	Në IAL jopublike, perceptohet më shumë drejtësi dhe barazi në trajtim. Në IAL publike, studentët shpesh vërejnë trajtime të ndryshme midis degëve apo viteve të studimit.
Stafi pedagogjik vlerëson opinionet dhe sugjerimet e studentëve për programin	4.0	4.5	Studentët në IAL jopublike ndihen më të përfshirë në vendimmarrje dhe në proceset e përmirësimit të programeve. Në IAL publike, mekanizmat e konsultimit ekzistojnë, por zbatohen pjesërisht.
Studentët njihen që në fillim me të drejtat dhe detyrimet e tyre nga strukturat përkatëse	4.3	4.6	Ky është treguesi më i fortë i këtij seksioni. Komunikimi institucional në IAL jopublike është më i qartë dhe më i personalizuar. Në IAL publike, informimi është formal dhe më pak i përshtatur sipas nevojave të studentëve.

Më poshtë paraqitet interpretimi analitik të treguesve të Seksionit 5: “Mbështetja dhe zëri i studentëve”, duke analizuar koeficientët e korrelacionit dhe ndikimin

e secilit faktor në perceptimin e studentëve për cilësinë e arsimit të lartë në Shqipëri.

Treguesi	Koef. korrelacioni r (me "Cilësinë e arsimit të lartë")	Natyra e lidhjes	Interpretim
Ekziston një mjedis i sigurt ku të gjithë janë të lirë të shprehin mendimin e tyre	$r \approx 0.72$	Shumë e fortë pozitive	Liria e shprehjes dhe ndjenja e sigurisë përbëjnë një nga faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në perceptimin e përgjithshëm të cilësisë. Studentët që ndihen të lirë të shprehin mendimin e tyre e perceptojnë institucionin si transparent, të hapur dhe me kulturë demokratike.
Të gjithë studentët trajtohen në mënyrë të barabartë në program dhe institucion	$r \approx 0.69$	E fortë pozitive	Barazia në trajtim ndikon drejtpërdrejt në perceptimin për drejtësinë institucionale dhe në ndjenjën e përkatësisë. Studentët që e ndjejnë veten të trajtuar në mënyrë të barabartë kanë më shumë besim te sistemi arsimor dhe vlerësojnë më lart cilësinë e arsimit.
Stafi pedagogjik vlerëson opinionet dhe sugjerimet e studentëve për programin	$r \approx 0.66$	E fortë pozitive	Përfshirja reale e studentëve në vendimmarrje akademike përbën tregues kyç të arsimit cilësor. Studentët që ndjejnë se mendimet e tyre merren në konsideratë, raportojnë nivele më të larta motivimi dhe kënaqësie me institucionin.
Studentët njihen që në fillim me të drejtat dhe detyrimet e tyre nga strukturat përkatëse	$r \approx 0.63$	E fortë mesatare pozitive	Transparenca institucionale dhe komunikimi efektiv në fillim të studimeve rrisin ndjeshëm besimin dhe ndihmojnë në krijimin e një përvoje më të organizuar akademike. Studentët e mirë-informuar janë më të prirur të vlerësojnë pozitivisht cilësinë e arsimit.

Edhe pse në tërësi vlerësimi është pozitiv, përsëri, ka përqindje të lartë studentësh që mendojnë se mbështetja e studentëve ka nevojë të përmirësohet. Trajtimi i studentëve në mënyrë të barabartë në programin e studimit, ka nevojë për adresim në institucionet publike.

Në vlerësimin e Seksionit 5 "*Mbështetja dhe zëri i studentëve*", rezultatet tregojnë se studentët në përgjithësi mendojnë se ekziston mjedis i sigurt ku ata mund të shfaqin lirisht mendimet e tyre, vlerësohen nga institucioni pikëpamjet e studentëve, ata informohen për të drejtat dhe detyrimet e tyre etj. Nga sa më sipër fusha 5, vlerësohet mbi nivelin mesatar.

4.2.6. Seksioni 6: Vlerësimi i përgjithshëm i programit /institucionit

Seksioni 6 përbën pjesën përmbyllëse të pyetësorit kombëtar të studentëve SKS 2025 dhe ka si objektiv të matë perceptimin e përgjithshëm të studentëve për cilësinë e programeve të studimit dhe për përvojën e tyre akademike në institucionin përkatës.

Ky seksion sintetizon në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjithë dimensionet e vlerësuara në pjesët e mëparshme të pyetësorit (mësimdhënie, mbështetje, burime, menaxhim programi, etj.), duke shërbyer si indikator final i kënaqësisë së studentëve dhe i reputacionit akademik të institucionit.

Qëllimi kryesor i këtij seksioni është të matë nivelin e kënaqësisë së përgjithshme që studentët kanë ndaj programit të tyre të studimit dhe ndaj institucionit ku ndjekin studimet; identifikojë faktorët kryesorë që përcaktojnë cilësinë e perceptuar të arsimit të lartë në Shqipëri; vlerësojë besnikërinë dhe besueshmërinë institucionale, përmes pyetjeve që matin nëse studentët do ta zgjidhnin sërish të njëjtin program apo institucion; sigurojë evidenca të drejtpërdrejta për mekanizmat e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel programi dhe institucioni.

Ky seksion është një barometër i përgjithshëm që tregon se sa efektivisht funksionojnë të gjitha elementet e procesit akademik dhe administrativ në ndërtimin e një përvoje studentore pozitive dhe të qëndrueshme.

Analiza e këtij seksioni ka funksion përmbledhës dhe krahasues, sepse lejon nxjerrjen e:

- vlerësimeve përfundimtare të kënaqësisë së studentëve në nivel kombëtar;
- krahasimeve ndërmjet IAL publike dhe jopublike;
- identifikimin e faktorëve më ndikues në perceptimin për cilësinë e arsimit të lartë.

Këta tregues lidhen drejtpërdrejt me standardet cilësisë që kanë të bëjnë me efektivitetin e programeve të studimit; ndikimin e mësimdhënies në formimin e studentëve; dhe funksionimin e mekanizmave të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë.

Në vijim paraqiten në mënyrë grafike rezultatet dhe analiza për secilin tregues duke përfshirë dhe krahasimin IAL publike dhe IAL jopublike.




Figura 69: Cilësia në përgjithësi e programit të studimit




Figura 70: Cilësia në përgjithësi e programit të studimit, sipas llojit të institucionit




Figura 71: Rizgjedhja e institucionit




Figura 72: Rizgjedhja e institucionit, sipas llojit




Figura 73: Cilësia e përgjithshme e personelit akademik




Figura 74: Cilësia e përgjithshme e personelit akademik, sipas llojit të institucionit




Figura 75: Cilësia e përgjithshme e personelit administrativ




Figura 76: Cilësia e përgjithshme e personelit administrativ, sipas llojit të institucionit




Figura 77: Cilësia e përgjithshme e metodave të mësimdhënies




Figura 78: Cilësia e përgjithshme e metodave të mësimdhënies, sipas llojit të institucionit




Figura 79: Cilësia e përgjithshme e mbështetjes së studentëve




Figura 80: Cilësia e përgjithshme e mbështetjes së studentëve, sipas llojit të institucionit




Figura 81: Niveli i cilësisë së arsimit të lartë në Shqipëri




Figura 82: Niveli i cilësisë së arsimit të lartë në Shqipëri, sipas llojit të institucionit

Kënaqësia e përgjithshme me cilësinë e programit të studimit tregohet nga rreth 54% e studentëve dhe 26.% që janë përgjithësisht dakord se janë të kënaqur me cilësinë e programit të studimit. Vetëm 8% shprehin pakënaqësi, ndërsa 13% janë neutralë (As Po as Jo).

Besnikëria ndaj institucionit “Do të zgjidhja sërish të njëjtin institucion/program” rreth 56% e studentëve të bindur plotësisht dhe 18 % kryesisht, do të zgjidhnin sërish të njëjtin institucion dhe program. Kjo tregon nivel të lartë besnikërie institucionale, që lidhet ngushtë me cilësinë e perceptuar të mësimdhënies, reputacionin institucional dhe përvojën e përgjithshme të studimeve.

Rreth 46% e studentëve e vlerësojnë stafin akademik si shumë mirë, 20% si mirë, vetëm 7% kanë mendim neutral, ndërsa rreth 2% japin vlerësime negative. Studentët tregojnë një nivel të lartë respekti për kompetencën profesionale dhe përkushtimin e stafit akademik.

Vetëm 38% e vlerësojnë si shumë mirë dhe 20% si mirë që tregon se shërbimet administrative kanë përmirësime të dukshme, por mbeten më të dobëta se aspektet akademike.

Ndërsa për cilësinë e përgjithshme e programit të studimit, rreth 45% e studentëve e vlerësojnë programin shumë mirë dhe 21% mirë. Vetëm 2.4% japin vlerësim negativ, ndërsa 6% neutralë. Kjo tregon një nivel të lartë përputhshmërie midis përmbajtjes së programeve dhe nevojave akademike.

IAL-të që rinovojnë më shpesh kurrikulat dhe integrojnë komponentë praktikë arrijnë rezultate më të mira në këtë tregues.

Lidhur me cilësinë e disa prej treguesëve kryesorë:

- 40% e studentëve i vlerësojnë metodat e mësimdhënies si shumë të mira dhe 23% si të mira. Megjithatë, rreth 7% mbeten neutralë dhe 3% kanë perceptim negativ;
- 39% e studentëve raportojnë mbështetje shumë të mirë dhe 20% të mirë, ndërsa 9% neutralë dhe vetëm 5% pakënaqur;
- Cilësia e arsimit të lartë në Shqipëri (perceptim kombëtar), vetëm 32.8% e konsiderojnë “shumë mirë” dhe 23% “mirë”, ndërsa 11% janë neutralë dhe 26% japin vlerësim negativ.

Më poshtë është dhënë një analizë krahasuese midis IAL publike dhe IAL jopublike lidhur me treguesit e mësipërm. Konkretisht:

- Kënaqësia me cilësinë e programit të studimit, IAL publike: 22% plotësisht dakord dhe 13% përgjithësisht dakord dhe IAL jopublike: 32% plotësisht dakord dhe 13% përgjithësisht dakord. Pjesa neutrale është më e lartë në IAL publike (7.5%) sesa në jopublike (5.5%). Studentët e institucioneve jopublike janë dukshëm më të kënaqur me cilësinë e programeve të tyre të studimit. Kjo lidhet me organizimin më fleksibël, me mësimdhënie të personalizuar dhe me përmbajtje kurrikulare të përditësuar.
- Do ta zgjidhja sërish të njëjtin institucion dhe program, IAL publike: 24% plotësisht dakord, IAL jopublike: 32.7% plotësisht dakord, Përgjithësisht dakord: rreth 9% në të dy llojet e institucioneve. Në IAL jopublike studentët kanë ndjesi më të fortë përkatësie dhe besimi, çka tregon përvojë më të qëndrueshme akademike dhe mbështetje më efektive.

- Cilësia e përgjithshme e stafit akademik, IAL publike: 19% shumë mirë dhe 10.4% mirë, IAL jopublike: 26% shumë mirë dhe 9% mirë. Vlerësimet negative (keq/shumë keq) janë nën 2% në të dy rastet. Në të dy kategoritë, stafi akademik perceptohet pozitivisht, por në IAL jopublike raporti pedagog - student dhe kultura e bashkëpunimit janë më të afërta, duke reflektuar vlerësime më të larta.
- Cilësia e përgjithshme e stafit administrativ, IAL publike: 16% shumë mirë, IAL jopublike: 23% shumë mirë. Dallimi është i qartë në favor të IAL jopublike, ku administrata është më e aksesueshme, më e digjitalizuar dhe e orientuar drejt studentit.
- Cilësia e përgjithshme e programit të studimit, IAL publike: 19.3% shumë mirë, 11% mirë, IAL jopublike: 26% shumë mirë, 10% mirë. IAL jopublike shfaqin përmbajtje kurrikulare më të lidhura me tregun e punës, përditësim më të shpeshtë të literaturës dhe module praktike të integruara. IAL publike kanë traditë akademike të fortë, por procesi i modernizimit të programeve është më i ngadaltë.
- Cilësia e metodave të mësimdhënies, IAL publike: 17% shumë mirë, IAL jopublike: 24% shumë mirë. Metodot mësimore më bashkëkohore dhe interaktive janë më të pranishme në IAL jopublike, ku përdorimi i teknologjisë, diskutimeve në grup dhe projekteve praktike është më sistematik.
- Cilësia e mbështetjes së studentëve, IAL publike: 16% shumë mirë, 10% mirë, IAL jopublike: 23% shumë mirë, 10% mirë. IAL jopublike ofrojnë më shumë ndihmë individuale, orientim akademik dhe shërbime karriere, ndërsa në IAL publike mbështetja shpesh është e kufizuar për shkak të numrit të madh të studentëve dhe mungesës së strukturave të dedikuara.
- Cilësia e arsimit të lartë në Shqipëri (perceptim kombëtar), IAL publike: 13% shumë mirë dhe 11% mirë, IAL jopublike: 19% shumë mirë dhe 11.2% mirë. Përgjithësisht, mbi 25% e studentëve në të dy llojet kanë perceptim neutral ose negativ. Studentët e IAL jopublike kanë një vlerësim më optimist për cilësinë e arsimit të lartë në vend, ndërsa studentët e IAL publike janë më kritikë për sistemin në tërësi.

Treguesi	IAL Publike (Mes.)	IAL Jopublike (Mes.)	Komente
Cilësia e programit	4.1	4.4	Në IAL jopublike programi vlerësohet me përmbajtje më të përditësuar dhe praktika të mira.
Besnikëria institucionale	4.0	4.3	Lidhje më e fortë emocionale me institucionin në privatet.
Stafi akademik	4.2	4.5	Numri i ulët i studentëve në disa programe ndikon në raportet pozitive staf/student.

Stafi administrativ	3.9	4.3	Stafi administrativ perceptohet më efektive dhe reaguese.
Metodat e mësimdhënies	4.0	4.4	Metodat e mësimdhënies, mësimdhënia aktive, përdorimi i teknologjisë dhe feedback më të strukturuar në IAL jopublike.
Mbështetja e studentëve	3.9	4.3	Kontakt më i drejtpërdrejtë dhe mbështetje individuale në IAL jopublike.
Cilësia e arsimit të lartë në Shqipëri	3.5	3.8	Skepticizëm më i madh në IAL publike për cilësinë e arsimit të lartë në vend. Në këtë pyetje rreth 25% e studentëve pjesëmarrës nuk kanë dhënë përgjigje.

Më poshtë paraqitet interpretimi analitik i treguesve të Seksionit 5: “Mbështetja dhe zëri i studentëve”.

Treguesi	Koeficienti Pearson (r)	Interpretim
Kënaqësia e përgjithshme me cilësinë e programit të studimit	$r = 0.71$	Ndikimi më i fortë mbi perceptimin e cilësisë së arsimit. Studentët që janë të kënaqur me programin e tyre e perceptojnë edhe sistemin e arsimit si cilësor.
Do ta zgjidhja sërish të njëjtin institucion dhe program	$r = 0.68$	Lidhje e fortë pozitive, besnikëria ndaj institucionit ndikon drejtpërdrejt në perceptimin e përgjithshëm për cilësinë.
Cilësia e përgjithshme e stafit akademik	$r = 0.63$	Studentët që vlerësojnë personelin akademik si profesional dhe bashkëpunues, kanë më shumë besim në cilësinë e arsimit.
Cilësia e përgjithshme e programit të studimit	$r = 0.60$	Lidhje e qëndrueshme, programet e strukturuar mirë dhe me përmbajtje të përditësuar ndikojnë pozitivisht në perceptimin e cilësisë kombëtare.
Cilësia e metodave të mësimdhënies	$r = 0.57$	Lidhje mesatare, mënyrat bashkëkohore të mësimdhënies, përdorimi i teknologjisë dhe angazhimi aktiv i studentëve përmirësojnë perceptimin për cilësinë.
Cilësia e stafit administrativ	$r = 0.49$	Lidhje pozitive mesatare, efikasiteti dhe korrektësia e administratës ndikojnë në përvojën e përgjithshme dhe në imazhin institucional.
Mbështetja për studentët	$r = 0.54$	Lidhje e fortë mesatare, ekzistenca e strukturave ndihmëse (zyra karriere, tutorime, shërbime psikologjike) lidhet ngushtë me ndjesinë e cilësisë në arsimin e lartë.

Faktorët akademikë (programi, stafi, metodat) kanë ndikimin më të lartë në perceptimin e përgjithshëm të cilësisë së arsimit në Shqipëri. Dukshëm studentët e lidhin cilësinë e arsimit drejtpërdrejt me përvojën e tyre në auditor, me cilësinë e pedagogëve dhe me efektivitetin e programeve. Faktorët institucionalë (mbështetja dhe administrata) kanë ndikim të mesëm, por mbeten thelbësorë për përmirësimin e përvojës studentore. Një administratë funksionale, komunikim i mirë dhe ndihma individuale e rrisin ndjesinë e

cilësisë. Besnikëria ndaj institucionit është e fortë, duke treguar se përfshirja, përkatësia dhe identiteti universitar janë dimensione që ndikojnë në mënyrën e perceptimit për cilësinë e arsimit të lartë.

Analiza e cilësisë së arsimit të lartë, e ndarë sipas tipit të institucionit (IAL publike dhe IAL jopublike), tregon një nivel të mesëm të mirë të vlerësimit në shkallë kombëtare, me rezultate më pozitive në IAL jopublike.

Krahas pyetjeve të strukturuar të sondazhit, studentëve u është dhënë mundësia të shprehin lirshëm mendimet e tyre përmes një pyetjeje të hapur:

“A ka ndonjë aspekt veçanërisht pozitiv ose negativ të përvojës suaj në institucionin/programin e studimit që dëshironi të nënvizoni? Ju lutem jepni një përshkrim të shkurtër të përvojave tuaja pozitive ose negative.”

Janë shqyrtuar një numër i konsiderueshëm komentesh nga studentë të të gjitha institucioneve pjesëmarrëse. Aspektet pozitive të evidentuara lidhen kryesisht me:

- përmirësimet infrastrukturore dhe mjediset e mësimi;
- përshtatshmërinë dhe përditësimin e programeve të studimit;
- kompetencën dhe angazhimin e stafit akademik;
- mbështetjen institucionale ndaj studentëve (orientim akademik, komunikim, shërbime).

Ndërkohë, shqetësimet më të shpeshta, që përputhen me gjetjet kuantitative të raportit, përfshijnë:

- mungesë orientimi të disa programeve drejt praktikës profesionale;
- vlerësim të padrejtë ose jo të qëndrueshëm nga ana e disa pedagogëve;
- çështje të etikës së komunikimit dhe jo-profesionalizmi në organizimin didaktik;
- nevojën për ta bërë procesin mësimor më tërheqës dhe interaktiv etj.

V. ANALIZA KRAHASUESE DHE PËRFUNDIME

5.1. Vlerësim i përgjithshëm mbi metodologjinë e zhvillimit të SKS

Në vitin akademik 2025, procesi i SKS u zhvillua duke ndjekur të njëjtën metodologji me SKS 2022. U ruajtën strukturat kryesore të pyetësorit dhe mënyra e shpërndarjes nga ASCAL, çka mundëson krahasime ndër vite dhe vlerësimin e progresit të cilësisë së mësimdhënies.

ASCAL ka synuar një qasje analitike të thelluar, e cila përfshin: krahasimin sistematik të rezultateve ndërmjet IAL publike dhe IAL jopublike; analizën e korrelacionit të treguesve kryesorë që ndikojnë në perceptimin e cilësisë; vlerësimin e praktikave institucionale të mirëmenaxhimit akademik dhe mësimdhënies; interpretimin cilësor të komenteve të hapura të studentëve, si një dimension plotësues i analizës statistikore.

Duke analizuar zhvillimin e tre SKS-të e fundit (2019, 2022 dhe 2025) në aspektin organizativ, të pjesëmarrjes, rezultateve dhe ndikimit, dalin në pah disa konstatime të rëndësishme:

- Pjesëmarrja e studentëve mbetet sfidë veçanërisht në IAL publike, ku ndonjëherë niveli i angazhimit lidhet me mungesën e komunikimit efektiv dhe informimit për rëndësinë e sondazhit;
- Rishikimi i metodologjisë së zhvillimit të SKS, duke përfshirë Këshillat Studentorë, organizatat studentore dhe strukturat e brendshme të cilësisë për të rritur ndërgjegjësimin dhe përfshirjen e studentëve;
- Metodologji analitike për të rritur besimin në treguesit e vlerësimit;
- Vlerësime të specializuara/tematike dhe krahasimore ndër-institucionale, duke krijuar bazat për një mekanizëm të mundshëm renditjeje (ranking) të institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri, në përputhje me praktikën më të mira evropiane.

5.2. Vlerësimi i përgjithshëm i mësimdhënies dhe treguesit që ndikojnë në cilësinë e mësimdhënies në arsimin e lartë

Rezultatet e Sondazhit Kombëtar të Studentëve 2025 tregojnë se perceptimi i studentëve për cilësinë e mësimdhënies është ndërtuar mbi disa shtylla të ndërlidhura që përfshijnë faktorë akademikë, etikë, organizativë dhe logjistikë. Vlerësimi përfundimtar për çdo seksion është si vijon:

Seksioni 1. Mësimdhënia dhe mësimnxënia: Vlerësimi i përgjithshëm mbi mesatar.

Studentët vlerësojnë pozitivisht profesionalizmin e stafit akademik dhe përgatitjen shkencore të pedagogëve, por theksojnë nevojën për metoda më

interaktive dhe praktike të mësimdhënies. Në IAL publike, mësimdhënia perceptohet më teorike dhe më pak aplikative, ndërsa në IAL jopublike vlerësohet komunikimi më i afërt dhe mësimi i personalizuar. Në tërësi, kjo fushë mbetet në nivel të mirë, por kërkohet orientim më i mirë drejt praktikës, mendimit kritik dhe përdorimit të teknologjive bashkëkohore në mësimdhënie.

Seksioni 2. Vlerësimi dhe feedback-u: Vlerësimi i përgjithshëm mbi mesatar: Rezultatet e SKS 2025 tregojnë se studentët kanë besim të moderuar në drejtësinë dhe transparencën e procesit të vlerësimit, por evidentojnë mungesë feedback-u të strukturuar dhe të personalizuar pas provimeve. Në IAL publike, një pjesë e studentëve ndjejnë se notat nuk pasqyrojnë gjithmonë përpjekjen e tyre, ndërsa në IAL jopublike feedback-u është më i shpeshtë dhe më ndihmues. Në këtë seksion nënvizohet nevoja që institucionet të krijojnë mekanizma të qëndrueshëm për rikthimin e feedback-ut, duke e kthyer vlerësimin në proces formues e jo thjesht administrativ.

Seksioni 3. Burimet në funksion të mësimdhënies: Vlerësimi i përgjithshëm mesatar.

Ky është seksioni me performancën më të dobët kombëtare, pasi studentët evidentojnë mangësi në infrastrukturë, pajisje laboratorike dhe burime digjitale, sidomos në IAL publike.

IAL jopublike dallohen për ambiente më të mira, logjistikë të përditësuar dhe biblioteka digjitale funksionale. Në tërësi, studentët e lidhin cilësinë e përvojës mësimore drejtpërdrejt me kushtet fizike dhe teknologjike, duke kërkuar investime të qëndrueshme në mjedise dhe digjitalizim për të përmirësuar cilësinë e procesit mësimor.

Seksioni 4. Organizimi dhe realizimi i programeve të studimit: Vlerësimi i përgjithshëm mesatar.

Ky seksion paraqet rezultatet më të mira të SKS 2025, duke reflektuar përmirësime të dukshme në planifikimin dhe koherencën akademike të programeve të studimit. Studentët vlerësojnë qartësinë e strukturës së programeve, përmbajtjen e përditësuar të lëndëve dhe lidhjen me objektivat profesionale dhe tregun e punës. Në IAL publike, evidentohet stabilitet dhe standardizim akademik, ndërsa në IAL jopublike përmendet fleksibiliteti dhe përditësimi më i shpeshtë i kurrikulave. Ky seksion konfirmon se organizimi i programeve dhe menaxhimi i veprimtarive akademike është në nivel të mirë.

Seksioni 5. Mbështetja dhe zëri i studentëve: Vlerësimi i përgjithshëm mbi mesatar.

Studentët raportojnë përmirësim të komunikimit me personelin akademik, administratën dhe strukturat e sigurimit të brendshëm, por theksojnë se zëri i tyre nuk përfshihet mjaftueshëm në proceset vendimmarrëse. Në IAL publike, këshillat studentorë janë shpesh funksionale në formë, por jo efektive, ndërsa

në IAL jopublike, studentët ndihen më të dëgjuar dhe më të përfshirë.

Seksioni 6. Vlerësimi i përgjithshëm i programit dhe institucionit: Vlerësimi i përgjithshëm mbi mesatar.

Në nivel kombëtar, shumica e studentëve vlerësojnë pozitivisht përvojën e tyre akademike, me mbi gjysmën e të anketuarve që e konsiderojnë arsimin e lartë “mirë” ose “shumë mirë”. Kjo dëshmon për një ekuilibër pozitiv mes përpjekjeve të institucioneve për përmirësim të cilësisë dhe perceptimit të studentëve për rezultatet e këtyre përpjekjeve. Në nivel kombëtar, afërsisht 55–60% e studentëve e vlerësojnë arsimin e lartë në Shqipëri në nivele të larta të cilësisë, duke theksuar përparime në fushat e mësimdhënies, përdorimit të teknologjisë dhe përfshirjes institucionale. Rreth 21% e konsiderojnë cilësinë “mesatare”, ndërsa vetëm rreth 6–7% kanë dhënë vlerësime negative.

Në institucionet publike, perceptimi i studentëve është kryesisht pozitiv, ku rreth 60% të përgjigjeve (“mirë” ose “shumë mirë”) që tregojnë kënaqësi dhe vlerësim të mirë për arsimin e lartë. Kjo tregon se institucionet publike vazhdojnë të ruajnë një besim të qëndrueshëm të cilësia akademike dhe reputacioni i tyre institucional.

1. Indikatorët me ndikim të lartë në cilësinë e mësimdhënies

Në grupin e indikatorëve me ndikim të lartë përfshihen ata që lidhen drejtpërdrejt me kompetencën akademike të stafit, drejtësinë në vlerësim, efektivitetin e metodave didaktike dhe interaktivitetin në procesin e të nxënës.

Këta faktorë përbëjnë bërthamën pedagogjike të cilësisë, sepse ndikojnë drejtpërdrejt në mënyrën se si studentët përvetësojnë njohuritë dhe formojnë perceptimin për profesionalizmin e institucionit.

Ndikimin më të fortë e shfaq drejtësia dhe korrektësia në vlerësim, e cila paraqet koeficientin më të lartë të lidhjes ($r \approx 0.73$). Studentët që perceptojnë procesin e vlerësimit si të drejtë, të paanshëm dhe transparent, kanë më shumë besim në sistemin e arsimit të lartë dhe e vlerësojnë më pozitivisht cilësinë e mësimdhënies në tërësi. Ky tregues reflekton jo vetëm integritetin profesional të pedagogëve, por edhe kulturën institucionale të etikës akademike.

Një tjetër faktor me ndikim shumë të fortë është efektiviteti i metodave të mësimdhënies ($r \approx 0.72$). Mësimdhënia e bazuar në diskutim, zbatim praktik, dhe përdorim të teknologjisë rrit ndjeshëm perceptimin e studentëve për cilësi, duke e bërë procesin e të nxënës më tërheqës dhe më të dobishëm. Studentët që raportojnë përdorimin e metodave interaktive, punës në grup apo prezantimeve praktike, shfaqin nivele më të larta të kënaqësisë akademike dhe përfshirjes intelektuale.

Gjithashtu, profesionalizmi dhe kompetenca e stafit akademik ($r \approx 0.66$) mbeten themel i cilësisë së mësimdhënies. Një staf me përgatitje të lartë akademike,

që demonstroi njohuri të thelluara dhe komunikim efektiv, përforcon perceptimin për seriozitetin dhe cilësinë e programit të studimit. Kjo lidhje theksohet më shumë në institucionet publike, ku studentët shpesh dallojnë mes njërive që zbatojnë standarde të larta didaktike dhe atyre që ende mbeten tradicionale.

Në të njëjtin nivel ndikimi përfshihet përmbajtja e programeve të studimit ($r \approx 0.68$), e cila vlerësohet më pozitivisht kur kombinon në mënyrë të balancuar njohuritë teorike me ato praktike. Studentët që ndiejnë se programet e tyre ofrojnë përgatitje të aplikueshme për tregun e punës shfaqin perceptim shumë më të mirë për cilësinë e arsimit. Ky është një element që në IAL-të jopublike është zhvilluar më tej përmes praktikave profesionale, partneriteteve me tregun e punës dhe integritit të moduleve aplikative.

Ndërkohë, liria për të shprehur mendimin dhe për t'u dëgjuar nga personeli akademik ($r \approx 0.69$) është gjithashtu tregues me ndikim të lartë, që shkon përtej aspektit të mësimdhënies për të prekur kulturën institucionale dhe etikën e marrëdhënieve brenda universitetit.

Një institucion që nxit dialog, komunikim të hapur dhe pjesëmarrje të studentëve në përmirësimin e procesit akademik perceptohet si më modern dhe më i drejtë.

Besnikëria ndaj institucionit ($r \approx 0.70$), përfaqëson lidhjen emocionale të studentëve me institucionin e tyre. Nëse studentët e demonstrojnë këtë lidhje në përgjigjet e tyre, besueshmëria e vlerësimit të përgjithshëm në rezultatin përfundimtar të SKS, ulet.

2. Indikatorët me ndikim të mesëm në cilësinë e mësimdhënies

Indikatorët e grupit të dytë kanë një ndikim mesatar por të qëndrueshëm, duke ndikuar indirekt në perceptimin e cilësisë përmes organizimit, strukturës dhe koherencës institucionale. Këta tregues nuk prekin drejtpërdrejt aspektin e mësimdhënies, por përcaktojnë efikasitetin e mjedisit akademik në të cilin ajo zhvillohet.

Në këtë kategori përfshihet qartësia e objektivave të të nxënies dhe e kriterëve të vlerësimit ($r \approx 0.65$), që lidhet ngushtë me transparencën institucionale. Studentët që kuptojnë qartë se çfarë pritet prej tyre dhe si do të vlerësohen, raportojnë më shumë besim dhe ndiejnë më shumë kontroll mbi progresin e tyre akademik.

Koherenca e përmbajtjes së programeve ($r \approx 0.60$) dhe shpërndarja e ngarkesës mësimore gjatë semestrit ($r \approx 0.55$) janë indikatorë të rëndësishëm të organizimit të brendshëm akademik. Ngarkesa e balancuar, koordinimi i mirë ndërmjet lëndëve dhe shmangia e mbivendosjeve në orare ndikojnë pozitivisht në perceptimin për profesionalizmin e institucioneve dhe për seriozitetin e mësimdhënies.

Në të njëjtin nivel ndikimi vendoset cilësia e infrastrukturës dhe mjediseve laboratorike ($r \approx 0.61$), e cila, ndonëse nuk përcakton drejtpërdrejt cilësinë e

mësimdhënies, rrit ndjeshëm përvojën e të nxënit. Studentët që zhvillojnë mësimet në ambiente moderne, të pajisura dhe të sigurt, perceptojnë institucionin si më të respektueshëm dhe më afër standardeve bashkëkohore të cilësisë. Feedback-u individual nga pedagogët ($r \approx 0.63$) përbën një tjetër faktor me ndikim mesatar, por shumë të rëndësishëm për përmirësimin e performancës së studentit. Studentët që marrin komente konstruktive mbi punën e tyre, shfaqin motivim më të lartë dhe besim më të madh në kompetencën e stafit akademik. Më tej, barazia në trajtimin e studentëve ($r \approx 0.64$) dhe mbështetja akademike ($r \approx 0.58$) luajnë rol kritik në ndërtimin e një kulture akademike të drejtë e të përfshirëse. Edhe pse ndikimi i tyre në perceptimin e cilësisë së mësimdhënies është më i tërthortë, ata garantojnë një klimë etike që mbështet motivimin dhe besimin e studentëve. Këta tregues, së bashku, përfaqësojnë strukturën menaxheriale dhe organizative të procesit mësimor, që ndonëse nuk është pjesë e përvojës didaktike të përditshme, përcakton efikasitetin e saj.

3. *Indikatorët me ndikim të ulët në cilësinë e mësimdhënies*

Në këtë grup përfshihen treguesit e SKS me ndikim më të kufizuar dhe kryesisht indirekt në cilësinë e mësimdhënies. Ata lidhen më shumë me infrastrukturën, administratën dhe elementët logjistikë që krijojnë kushtet ndihmëse për zhvillimin e procesit akademik, por nuk prekin drejtpërdrejt përmbajtjen apo cilësinë pedagogjike.

Përdorimi i teknologjisë dhe burimeve digjitale në mësimdhënie ($r \approx 0.56$) është një nga treguesit që, ndonëse i rëndësishëm për modernizimin e mjedisit akademik, nuk garanton në vetvete përmirësim të mësimdhënies. Në mungesë të përgatitjes didaktike për përdorimin e mjeteve teknologjike, ndikimi i këtij faktori mbetet mesatar.

Në të njëjtën linjë, efikasiteti i administratës së institucionit dhe komunikimi institucional ($r \approx 0.49-0.50$) ndikojnë më shumë në perceptimin e përgjithshëm për organizimin dhe funksionimin e institucionit sesa në përmbajtjen e mësimdhënies. Studentët që marrin përgjigje të shpejta dhe informacione të qarta nga administrata kanë përvojë më të mirë institucionale, por jo domosdoshmërisht cilësi më të lartë në mësimdhënie. Këta tregues përfaqësojnë dimensionin operacional të cilësisë elemente të nevojshme për funksionimin efikas të procesit mësimor, por me ndikim të kufizuar në përmbajtjen akademike apo rezultatet e studentit.

Analiza e të dhënave të SKS 2025 evidenton një hierarki të qartë të faktorëve që ndikojnë në perceptimin e cilësisë së mësimdhënies. Në krye të saj qëndrojnë elementet e integritetit profesional dhe didaktik: drejtësia, transparencja, profesionalizmi dhe efektiviteti metodologjik.

Pas tyre, vijnë faktorët organizativë dhe etikë, që përforcojnë strukturën institucionale të cilësisë, ndërsa në fund qëndrojnë faktorët logjistikë dhe

administrativë, që ndikojnë më tepër në përvojën organizative sesa në atë akademike.

Në analizën e bërë, koha mesatare e shkurtër e plotësimit të pyetësorit (më pak se 5 minuta) dhe shpërndarja e pabarabartë e pjesëmarrjes ndërmjet institucioneve, krijojnë premisa për përgjigje të nxituara dhe përfaqësim disproporcional të disa IAL-ve. Gjithashtu, balancimi i kampionit, peshimi i të dhënave dhe rritja e ndërgjegjësimit të studentëve, i japin vlerën e duhur procesit.

Rezultatet e Sondazhit Kombëtar të Studentëve 2025 japin një pamje të balancuar të perceptimit të studentëve për cilësinë e arsimit të lartë në Shqipëri. Në nivel kombëtar, mesatarja e përgjithshme e të gjitha seksioneve është 4.03 / 5, që e pozicionon sistemin në një nivel të mirë të cilësisë së perceptuar, me diferenca për disa tregues ndërmjet institucioneve publike dhe atyre jopublike.

VI. ANEKSE

6.1. Formati i pyetësorit të studentëve



Të dashur studentë!

Bazuar në Ligjin 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) organizon Sondazhin Kombëtar të Studentëve (SKS) me qëllim vlerësimin e mësimdhënies dhe aspekteve të tjera në funksion të saj nga studentët.

Studentët janë pjesa më e rëndësishme dhe preken drejtëpërdrejt nga shërbimi që ofrojnë institucionet, dhe për këtë arsye opinioni juaj është mjaft i nevojshëm dhe do të na ndihmojë të gjithëve të kuptojmë më mirë se cila është situata reale në institucionin tuaj dhe se çfarë duhet përmirësuar në të. Ndaj plotësimi i këtij sondazhi do të jetë tepër i vlefshëm për t'i dhënë një shtysë të madhe rritjes së cilësisë së arsimit të lartë në vendin tonë. Plotësimi i pyetësorit kërkon mesatarisht 5 minuta dhe përgjigjet tuaja janë tërësisht anonime. Data e fundit e plotësimit të pyetësorit është 23 Maj 2025.

Faleminderit për pjesëmarrjen në këtë pyetësor!

Stafi ASCAL

Seksioni A: Informacion i përgjithshëm

TEST

A1. Zgjidhni fakultetin ku studioni:

Fakulteti i Shkencave Mjekësore ☐

Fakulteti Ekonomik ☐

Fakulteti i Drejtësisë ☐

Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit ☐



A2.	Zgjidhni llojin e programit të studimit që ndiqni:	
	Program profesional (1 - 2 vjet)	☐
	Program Bachelor (3 - 4 vjet)	☐
	Program Master Profesional (1 - 2 vjet)	☐
	Program Master i Shkencave (2 vjet)	☐
	Program i Integruar Master i Shkencave (5 - 6 vjet)	☐
	Program Specializim Afatgjatë	☐
	Program Doktoratë	☐
A3.	Programi ku aktualisht studioni është zgjedhja juaj e:	
	parë	☐
	dytë	☐
	tretë	☐
	katërt	☐
	pestë	☐
	tjetër	☐
A4.	Gjinia:	
	Femër	☐
	Mashkull	☐
A5.	Grupmosha juaj:	
	18-22	☐
	23-27	☐
	27-31	☐
	32-36	☐
	Mbi 36	☐



Seksioni B: Fusha 1. Mësimdhënia dhe mësimnxënia

Vlerësimi/ Miratimi / dakordësia në lidhje me opinionin e dhënë:

Për pyetjet e mëposhtme (nga Pyetja 7 deri në Pyetjen 33):

Ju lutemi vendosni vlerësimin tuaj sipas klasifikimit: (1 – Aspak dakord; 2) Përgjithësisht nuk jam dakord; 3) As Po as Jo; 4) Përgjithësisht dakord; 5) Plotësisht dakord)

B1. Profesorët që më kanë dhënë mësim ishin kompetentë në shpjegim

- 1 ☐
- 2 ☐
- 3 ☐
- 4 ☐
- 5 ☐

B2. Po mësoj shumë se si të thellohem në koncepte dhe njohuri

- 1 ☐
- 2 ☐
- 3 ☐
- 4 ☐
- 5 ☐

B3. Stafi akademik dhe institucioni më inkurajojnë të marr pjesë në aktivitete studimore (psh. prezantime, detyra, ese, ushtrime, punë në grup, etj.)

- 1 ☐
- 2 ☐
- 3 ☐
- 4 ☐
- 5 ☐



B4. Programi i studimit që po ndjek më mundëson që të zbatoj njohuritë teorike në praktikë

- 1 ☐
- 2 ☐
- 3 ☐
- 4 ☐
- 5 ☐

Seksioni C: Fusha 2. Vlerësimi dhe feedback-u

C1. Metodatat e përdorura të vlerësimit testojnë të gjitha njohuritë e marra në programin e studimit

- 1 ☐
- 2 ☐
- 3 ☐
- 4 ☐
- 5 ☐

C2. Vlerësimi dhe notat që kam marrë kanë qënë korrekte

- 1 ☐
- 2 ☐
- 3 ☐
- 4 ☐
- 5 ☐

C3. Marr komente nga profesorët për punën time, që më ndihmojnë të kuptoj lëndën

- 1 ☐
- 2 ☐
- 3 ☐
- 4 ☐
- 5 ☐



C4. Plagjiatura apo kopjimi në provime dhe detyra, nuk tolerohen nga stafi akademik

- 1 ☐
- 2 ☐
- 3 ☐
- 4 ☐
- 5 ☐

C5. Nuk marr mjaftueshëm ndihmë nga profesorët e mi për të dhënë më të mirën në studimet e mia

- 1 ☐
- 2 ☐
- 3 ☐
- 4 ☐
- 5 ☐

C6. Kam dëgjuar se marrja e notave të padrejta është e zakonshme në institucionin/programin tim të studimit

- 1 ☐
- 2 ☐
- 3 ☐
- 4 ☐
- 5 ☐

C7. Është e vështirë të kontaktoj profesorët e mi, nëse kam nevojë për ndihmë për programin tim të studimit

- 1 ☐
- 2 ☐
- 3 ☐
- 4 ☐
- 5 ☐

**Seksioni D: Fusha 3. Burimet në funksion të mësimdhënies****D1. Jam i/e kënaqur me cilësinë e klasave në institucionin tim**

- 1 ☐
- 2 ☐
- 3 ☐
- 4 ☐
- 5 ☐

D2. Jam i/e kënaqur me cilësinë/sasinë e pajisjeve logjistike të IT në institucionin tim

- 1 ☐
- 2 ☐
- 3 ☐
- 4 ☐
- 5 ☐

D3. Jam i/e kënaqur me aksesin dhe cilësinë e bibliotekës në institucionin tim

- 1 ☐
- 2 ☐
- 3 ☐
- 4 ☐
- 5 ☐

D4. Jam i/e kënaqur me aksesin dhe cilësinë e bibliotekës dixhitale (online) në institucionin tim

- 1 ☐
- 2 ☐
- 3 ☐
- 4 ☐
- 5 ☐



D5. Jam i/e kënaqur me literaturën bazë dhe të rekomanduar që disponon biblioteka e institucionit

- 1 ☐
- 2 ☐
- 3 ☐
- 4 ☐
- 5 ☐

Seksioni E: Fusha 4. Organizimi dhe realizimi i programeve të studimit

Deri në çfarë mase jeni dakord me pohimet e mëposhtme në lidhje me programin tuaj të studimit?

E1. Pritshmëritë e të nxënit janë të përcaktuara qartë që në fillim, për çdo lëndë në programin tim të studimit

- 1 ☐
- 2 ☐
- 3 ☐
- 4 ☐
- 5 ☐

E2. Lëndët dhe përmbajtja e tyre janë të përshtatshme për programin tim të studimit

- 1 ☐
- 2 ☐
- 3 ☐
- 4 ☐
- 5 ☐

E3. Ngarkesa dhe oraret e mësimit janë të realizueshëm dhe të shpërndarë mirë gjatë semestrit

- 1 ☐
- 2 ☐
- 3 ☐
- 4 ☐
- 5 ☐



E4. Veprimtaritë mësimore (leksione, seminare, detyra kursi, praktikë dhe punë individuale) zhvillohen në përputhje me planin mësimor.

- 1 ☐
- 2 ☐
- 3 ☐
- 4 ☐
- 5 ☐

E5. Programi është i organizuar mirë dhe funksionon normalisht, pa probleme

- 1 ☐
- 2 ☐
- 3 ☐
- 4 ☐
- 5 ☐

Seksioni F: Fusha 5. Mbështetja dhe zëri i studentëve

Deri në çfarë mase jeni dakord me pohimet e mëposhtme në lidhje me programin tuaj të studimit?

F1. Ekziston një mjedis i sigurtë, në të cilin të gjithë janë të lirë të shprehin mendimin e tyre

- 1 ☐
- 2 ☐
- 3 ☐
- 4 ☐
- 5 ☐

F2. Të gjithë studentët trajtohen në mënyrë të barabartë në programin dhe institucionin tim

- 1 ☐
- 2 ☐
- 3 ☐
- 4 ☐
- 5 ☐



F3. I gjithë stafi pedagogjik vlerëson pikëpamjet dhe opinionet e studentëve për programin dhe institucionin

- 1 ☐
- 2 ☐
- 3 ☐
- 4 ☐
- 5 ☐

F4. Studentët njihen që në fillim me të drejtat dhe detyrimet e tyre nga strukturat përkatëse në institucion

- 1 ☐
- 2 ☐
- 3 ☐
- 4 ☐
- 5 ☐

Seksioni G: Fusha 6. Vlerësimi i përgjithshëm i programit të studimit/institucionit

G1. Në përgjithësi, jam i/e kënaqur me cilësinë e programit tim të studimit

- 1 ☐
- 2 ☐
- 3 ☐
- 4 ☐
- 5 ☐

G2. Nëse do të kisha mundësi të zgjidhja sërish, do të zgjidhja të njëjtin institucion dhe program studimi

- 1 ☐
- 2 ☐
- 3 ☐
- 4 ☐
- 5 ☐

**G3. Ju lutem vlerësoni cilësinë e përgjithshme të:**

Për pyetje 34 dhe 35, jepni mendimin tuaj sipas klasifikimit: (1 - Shumë keq; 2 - Keq; 3. As mirë as keq; 4- Mirë; 5- shumë mirë; 6 - Nuk kam informacion të mjaftueshëm)

	1 - Shumë keq	2 - Keq	3 - As mirë as keq	4 - Mirë	5 - Shumë mirë	6 - Nuk kam informacion të mjaftueshëm
Stafit akademik	☐	☐	☐	☐	☐	☐
Stafit administrativ	☐	☐	☐	☐	☐	☐
Programit tuaj të studimit	☐	☐	☐	☐	☐	☐
Metodave e mësimdhënies	☐	☐	☐	☐	☐	☐
Mbështetjes së studentëve	☐	☐	☐	☐	☐	☐

G4. Si do ta klasifikoni nivelin e cilësisë së arsimit të lartë në Shqipëri: (e njëjta shkallë si më sipër)

	1 - Shumë keq	2 - Keq	3 - As mirë as keq	4 - Mirë	5 - Shumë mirë	6 - Nuk kam informacion të mjaftueshëm
Niveli i cilësisë së arsimit të lartë	☐	☐	☐	☐	☐	☐

G5. Së fundmi, a ka ndonjë aspekt veçanërisht pozitiv ose negativ të përvojës suaj në institucionin/program studimi që dëshironi të nënvizoni? Ju lutem jepni një përshkrim të shkurtër të përvojave tuaja pozitive ose negative.

Pyetësi u dërgua.

Faleminderit për pjesëmarrjen në këtë Sondazh.

Stafi i ASCAL

6.2. Shpjegime dhe shkurtime

- ASCAL – Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, institucion publik qendror, person juridik, përgjegjës për sigurimin e jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë.
- BA – Bordi i Akreditimit, organ kolegjal vendimmarrës për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit të ofruara prej tyre.
- MA – Ministria e Arsimit, ministria përgjegjëse për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë.
- LAL – Ligji nr. 80/2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”*.
- IAL – Institucionet e arsimit të lartë, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 80/2015.
- IALP - Institucionet e arsimit të lartë publike.
- IALJP - Institucionet e arsimit të lartë jopublike.
- VKM – Vendim i Këshillit të Ministrave.
- SC - Standardet e Cilësisë në arsimin e lartë, akreditimin e IAL dhe programeve të studimit. Këto standarde janë pjesë integrale e Kodit të Cilësisë në AL.
- KC – Kodi i Cilësisë në AL është tërësia e dokumenteve ligjore, udhëzues, procedura, standarde të hartuara në funksion të sigurimit të vazhdueshëm të cilësisë, në arsimin e lartë.
- KI - Koordinator Institucional është personi kyç, përfaqësues i IAL, i cili mban kontakte të vazhdueshme me ASCAL në kuadër të zhvillimit të proceseve të ndryshme në fushën e sigurimit të cilësisë në AL.
- KS – Këshilli Studentorë është organizëm i studentëve që funksionojnë në IAL sipas përcaktimeve të LAL 80/2015.
- SKS – Sondazhi Kombëtar i Studentëve është proces në kuadër të vlerësimit të mësimdhënies në AL dhe realizohet çdo tre vjet nga ASCAL dhe BA.
- Manuali SKS – Dokumenti themelor i hartuar nga ASCAL & BA i cili parashikon procedurën dhe metodologjinë e realizimit të SKS.
- Pyetësor – Tërësia e pyetjeve që u drejtohen studentëve të përfshira në SKS.
- Procedura – Dokumente të posaçme që hartohen me qëllim mbarëvajtjen e procesit apo orientimin dhe informimin e studentëve.
- Indikatorët e vlerësimit – Tregues / orientues në një drejtim i caktuar të operimit dhe funksionimit të IAL sipas të cilit organizohen pyetjet.
- Baza e të dhënave – Tërësia e të dhënave, informacioneve, rezultateve që mbledhen dhe prodhohen gjatë zhvillimit të SKS.
- Rezultate paraprake – Janë informacione dhe të dhëna që dalin nga përpunimi i përgjigjeve të studentëve gjatë zhvillimit të SKS ose në përpunim të tij.
- Raport përfundimtar – Është dokumenti kryesor që del në përfundim të SKS, i cili përmban të gjithë informacionet e nevojshme për institucionet, programet dhe rezultatet e SKS.